


ZHVATJA SEKSUALE SI VEPËR E KORRUPSIONIT:

PËRGJIGJE JURIDIKE DHE INSTITUCIONALE



ISBN: 978-92-9271-010-1



**ZHVATJA SEKSUALE
SI VEPËR E KORRUPSIONIT:
PËRGJIGJE
JURIDIKE DHE
INSTITUCIONALE**

Dhjetor 2021



TITULL: Zhvatja seksuale si vepër e korrupsionit:
përgjigje juridike dhe institucionale

Autorë: Dr. Marija Risteska
Lupka Trajanovska MA

**Përktheu dhe
lekturoi:** BESTEL SHPKNJP Shkup

www.osce.org/skopje
© OSCE Mission to Skopje 2021

osbe Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Shkup

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Përmbajtja e këtij botimi mund të shfrytëzohet dhe shumëzohet për qëllime arsimore dhe qëllime tjera jokomerciale, me kusht që gjatë çdo riprodhimi të tillë si burim të ceket Misioni i OSBE-së në Shkup.

Materialet në këtë botim shërbejnë vetëm për referim më të lehtë. Megjithëse Misioni i OSBE-së në Shkup kushton kujdes më të madh gjatë zhvillimit të tyre, ai nuk pranon kurrfarë përgjegjësie për saktësinë dhe plotësinë e informatave, udhëzimeve dhe këshillave të dhënë ose për çfarëdo gabimi të ndodhur gjatë shtypjes. Përmbajtja e këtij publikimi, qëndrimet, mendimet, konstatimet, interpretimet dhe konkluzionet e shprehura këtu nuk e pasqyrojnë domosdo politikën ose qëndrimin zyrtar të OSBE-së. Andaj, nuk mund të ketë kërkesa ndaj OSBE-së lidhur me pasojat potenciale nga kopjimi i informatave ose konkluzioneve të përfshira në këtë botim.

Përmbajtja:

HYRJE	5
Çfarë është zvatja seksuale ose sekstorcioni si vepër e korrupsionit?	5
Cilat kushte duhet të plotësohen që zvatja seksuale të jetë vepër e korrupsionit?	7
Zhvatja seksuale dhe ndikimi i barazisë gjinore	8
Qasja metodologjike në hulumtim	11
ANALIZA JURIDIKE	13
Kryqëzimi i korrupsionit dhe dhunës me bazë gjinore	13
Përcaktimi terminologjik dhe raporti kryerës-viktimë e zvatjes seksuale	19
Përgjegjësia kundërvajtëse ose penale?	21
Procedura e denoncimit dhe veprimet	23
KONTEKSTI NDËRKOMBËTAR	26
Analiza e konventave dhe iniciativave ndërkombëtare	26
Konventa e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) për luftë kundër korrupsionit	26
Konventa e së Drejtës Penale për korrupsion e Këshillit të Evropës	27
Konventa e së Drejtës Civile për korrupsion e Këshillit të Evropës	28
Grupi i shteteve kundër korrupsionit – Këshilli i Evropës	28
Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalim dhe Luftë Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje – Konventa e Stambollit	29
ANALIZA KRAHASUESE LIGJORE	31
Shtetet e Ballkanit Perëndimor	31
Mali i Zi	31
Bosnja dhe Hercegovina	32
• Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës	32
• Republika Srpska	33
Shtetet anëtare të Bashkimit Evropian	34
Slllovenia	34
Finlanda	35
Shtetet anëtare të OSBE-së	35
Zvicra	35
Kirgistani	36
Shtete nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës	37
Kalifornia	37
Arkanzasi	38



KONSTATIMET KRYESORE NGA INTERVISTAT DHE GRUPET E FOKUSIT	40
Konstatimet kryesore që u nxorën nga intervistat	40
Njohja e formave gjinore të korrupsionit.....	40
Përfaqësimi i zhvatjes seksuale në Republikën e Maqedonisë së Veriut.....	40
Denoncimi dhe sanksionimi i zhvatjes seksuale.....	41
Rregullativa ligjore.....	41
Përgjigja institucionale.....	42
Konstatimet kryesore që u nxorën nga grupi i fokusit me përfaqësuesit e vetëqeverisjes lokale	42
Njohja e formave gjinore të korrupsionit.....	42
Përfaqësimi i zhvatjes seksuale në Republikën e Maqedonisë së Veriut.....	42
Denoncimi dhe sanksionimi i zhvatjes seksuale.....	43
Rregullativa ligjore.....	43
Përgjigja institucionale.....	43
Konstatimet kryesore që u nxorën nga grupi i fokusit me përfaqësuesit e sektorit civil	44
Njohja e formave gjinore të korrupsionit.....	44
Përfaqësimi i zhvatjes seksuale në Republikën e Maqedonisë së Veriut.....	44
Denoncimi dhe sanksionimi i zhvatjes seksuale.....	45
Rregullativa ligjore.....	45
Përgjigja institucionale.....	45
Konkluzionet e përgjithshme	46
KULTURA DHE VETËDIJA	47
REKOMANDIME	50
Rekomandime për rregullim juridik të zhvatjes seksuale si formë e korrupsionit.....	50
Rekomandime për përgjigje institucionale efikase ndaj rasteve të zhvatjes seksuale.....	50
Rekomandimi legjislativ për rregullimin e zhvatjes seksuale në Kodin Penal.....	51
Propozimi 1.....	52
Propozim 2.....	53
Draft-propozimet për rregullimin e zhvatjes seksuale në Ligj për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave.....	53
Draft-dispozita për rregullimin e zhvatjes seksuale në Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen e grave nga dhuna dhe dhuna në familje.....	54
ANEKSI I	55
Lista e faktorëve të intervistuar relevantë.....	55
Lista e përfaqësuesve të njërive të vetëqeverisjes lokale me të cilat janë mbajtur grupe të fokusit.....	56
Lista e përfaqësuesve të sektorit civil me të cilat janë mbajtur grupe të fokusit.....	56

Hyrje

Çfarë është zhatja seksuale ose sekstorcioni si vepër e korrupsionit?

Zhatja seksuale ose sekstorcioni ndodh kur njerëzit detyrohen për shërbime seksuale në këmbim për kryerjen e funksionit të besuar. Për faktin që shkelësit e keqpërdorin funksionin e tyre për qëllime personale, vepra kualifikohet si korrupsion. Ekzistojnë hulumtime si ajo e Bullock ans Jenkins (2020) që tregojnë se korrupsioni në përgjithësi ka efekt më të madh negativ ndaj grupeve të marginalizuara që është si rezultat i asimetrisë që ekziston lidhur me pozitat e fuqisë në vendimmarrje ose punë¹. Femrat janë proporcionalisht më shumë viktime të zhatjes seksuale sesa meshkujt.

Ekzistojnë dy lloje të korrupsionit:

- (i) korrupsion i kontraktuar ku palët e përfshira në korrupsion kanë marrëveshje paraprake e cila bën që vepra e korrupsionit të bëhet me vullnet të dyanshëm të palëve; dhe
- (ii) korrupsion zhatës ku njëra palë është e përfshirë në zhatje të drejtpërdrejtë, të hapur ose të tërthortë, të fshehur ndaj palës tjetër, viktimës².

Zhatja mund të jetë në para, dhurata, madje edhe seks në këmbim për qasje në shërbime, të mirat ose procedurat me të cilat personi që zhat udhëheq, sjell vendime ose menaxhon me to. Lloji i parë i korrupsionit të kontraktuar përfshin “insajderë” dhe klientë të tyre të cilët merren vesh bashkërisht që të përfitojnë nga funksioni publik ose të kenë përparësi para të tjerëve të cilët garojnë në treg. Ky lloj i korrupsionit përfshin figura të fuqishme të jetës politike dhe ekonomike, ndërsa lloji i dytë i korrupsionit të zhatur më tepër i përfshin grupet e marginalizuara të cilat nuk kanë qasje në fuqinë, e që kryesisht në këto raste janë femrat. Disa femra janë të detyruara që të japin shërbime seksuale në këmbim të shërbimeve elementare publike, përfshirë edhe shërbimet shëndetësore ose arsimore. Stereotipat gjinore dhe pritshmëritë e formuara prej tyre nga sjellja e meshkujve dhe femrave, i vënë femrat në pozitë më të cënueshme duke i detyruar që të shfrytëzojnë seksin si “valutë” për blerje/marrje të shërbimit, qasje në të mirat publike ose pozitë të punës; të cilat u takojnë nëse sistemi nuk është i korruptuar. Hulumtimet tregojnë se gratë dhe grupet e tjera të marginalizuara janë më shumë të rrezikuara nga korrupsioni zhatës sepse kanë qasje më të vogël në drejtësi dhe mbrojtje nga eksploatimi³.

¹ Bullock, Jessie and Matthew Jenkins (2020). Corruption and marginalization, Transparency international, available online: <https://knowledgehub.transparency.org/assets/uploads/helpdesk/Corruption-and-marginalisation.pdf>

² Gabriela Camacho (2020) Corruption and gender equality: A summary of existing research, Transparency international, available online <https://www.u4.no/publications/corruption-and-gender-equality-hd.pdf>

³ Bullock, Jessie and Matthew Jenkins (2020). Corruption and marginalization, Transparency international, available online: <https://knowledgehub.transparency.org/assets/uploads/helpdesk/Corruption-and-marginalisation.pdf>



Sekstorcioni është formë e eksploatimit seksual dhe korrupsionit zхватës ku personi në pozitë vendimmarrëse ose me autoritet e keqpërdor pozitën dhe fuqinë që e posedon me qëllim për të zhvatur aktivitet të padëshiruar seksual nga një person tjetër në këmbim për shërbimin, të mirat, qasjen në resurset me të cilat menaxhon, për të cilën vendos ose udhëheq personi i parë⁴. Nocioni sekstorcion si një lloj i korrupsionit për herë të parë është përdorur në vitin 2008 nga Shoqata Ndërkombëtare e Grave Gjykatëse (IAWJ), kur anëtarët kanë vërejtur dhe gjykatësit e rajoneve të ndryshme kanë paraqitur se njohin një lloj specifik të korrupsionit për të cilin diskutohet rrallë⁵. Që atëherë, nocioni “sekstorcion” është miratuar nga disa organizata dhe mund të gjendet në literaturë. Megjithatë, fenomeni ende përmendet më së shpeshti në literaturë me nocione tjera, siç janë “seksi i transaksionit”, “shqetësimi seksual” ose “shërbime seksuale.”⁶ Në këtë studim në vend të sekstorcionit do të shfrytëzohet nocioni zхватje seksuale sepse e përfshin qenien e veprës dhe bëhet fjalë për një fjalë të sajuar e cila është krijuar nga nocione që shfrytëzohen në gjuhën maqedonase në vend të fjalës së huaj sekstorcion.

⁴ Asociacioni ndërkombëtar i avokatëve e definojnë sekstorcionin si këmbim të seksit në vend të parave për të fituar qasje në dobi/benefit të caktuar në të cilin viktimat e sekstorcionit ka mundur të arrijë ligjërisht, përkatësisht e cila dobi viktimës i ka takuar (shih në International Bar Association - IBA. 2019. Sextortion: A crime of corruption and sexual exploitation).

⁵ Maja L Lazarova (2020), Aspektet gjinore të korrupsionit me vështrim në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Misioni i OSBE-së në Shkup, i arritshëm online: <https://www.osce.org/files/f/documents/c/4/480937.pdf>

⁶ Hazel Feigenblatt (2020), Breaking the silence around sextortion: The links between power, sex and corruption, Transparency International, available online: <https://www.transparency.org/en/publications/breaking-the-silence-around-sextortion>

Cilat kushte duhet të plotësohen që zhvatja seksuale të jetë vepër e korrupsionit?

Duhet të ekzistojnë dy elemente që zhvatja seksuale të konsiderohet si vepër e korrupsionit:

Aktiviteti seksual

➤ Përfshin në mënyrë implicite dhe eksplicite kërkesën për përfshirje në ndonjë lloj aktiviteti të padëshiruar seksual, që mund të variojë nga marrëdhënia seksuale e deri te zbulimi i pjesëve të trupit

Korrupsioni

➤ Personi që kërkon aktivitet seksual patjetër duhet të jetë në pozitë të autoritetit, të cilën e keqpërdor me kërkesë ose pranim të aktit seksual në këmbim për të kryer funksionin që i është besuar - respektivisht, keqbërësit e keqpërdorin funksionin e tyre për qëllime personale.

Ndërsa për ta konsideruar veprën si korrupsion, patjetër duhet të plotësohen tri kushtet si vijon:

1. Keqpërodrimi i funksionit publik.

2. Quid pro quo ose „diçka për diçka“ - keqbërësi kërkon ose pranon shërbime seksuale në këmbim të sigurimit të dobisë për të cilën është i autorizuar - respektivisht ka fuqi.

3. Detyrimi psikologjik - zhvatja seksuale më tepër bazohet në presionin e detyruar se sa në dhunën psikike për të fituar shërbime seksuale.

Mosbalancimi i fuqisë ndërmjet keqbërësit dhe viktimës i lejon shkelësit që të bëjë presion për detyrim.



Zhvatja seksuale dhe ndikimi i barazisë gjinore

Perspektiva gjinore në korrupsion është hulumtuar shumë pak, andaj edhe nuk dihet se sa është vëllimi i shfrytëzimit të zhvatjes seksuale si vepër e korrupsionit, e as se cili është ndikimi i barazisë gjinore në këtë fenomen. Megjithatë ekzistojnë studime të cilat identifikojnë katër sfera ku gruaja është më e nënshtruar dhe mund të jetë viktimë e këtij lloji të korrupsionit:

- 1) gjatë qasjes në shërbime publike, tregje dhe kredi;
- 2) pjesëmarrje politike;
- 3) vepra penale me bazë gjinore (si eksploatimi seksual, tregtia me njerëz, etj.); dhe
- 4) moskujdesi dhe keqmenaxhimi⁷.

Për shkak të sistemit gjinor në të cilin gratë megjithëse kanë të drejta të barabarta, por për shkak të traditave, zakoneve, roleve dhe stereotipave dominuese gjinore, nuk i realizojnë në tërësi të drejtat e tyre dhe de facto janë të pabarabarta me burrat në aspekt ekonomik, politik dhe shoqëror. Gratë për shkak të diskriminimit historik ndaj tyre janë më të cenueshme dhe për shkak se janë më pak të arsimuara, nuk kanë llogari të veta bankare, pronë në emrin e tyre dhe kjo i pamundëson që të kenë qasje në shërbime publike, tregje dhe kredi. Goetz 2007⁸; IAWJ 2012⁹; Transparency International 2019¹⁰; UNDP-Huairou Commission 2012¹¹ vërejnë se gratë janë të ekspozuara më shpesh ndaj korrupsionit në sektorët e arsimit, mbrojtjes shëndetësore, qasjes në ujë dhe sanitet, banim, si dhe gjatë marrjes së dokumenteve personale (përfshi edhe vizat). Sipas drejtoreshës së Akademisë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë, në Republikën e Maqedonisë së Veriut ky fenomen “më së shumti paraqitet kur gruaja kërkon të drejta të caktuara të cilat i takojnë, ndërsa varen nga një bartës i caktuar i fuqisë, pushtetit,

⁷ SIDA. 2015. Gender and Corruption Brief

⁸ Goetz, Anne Marie (2007). “Political Cleaners: women as the New AntiCorruption Force?” Development and Change 38(1):

⁹ International Association of Women Judges (IAWJ) (2012) Stopping the Abuse of Power through Sexual Exploitation. Naming, shaming and ending sextortion. A Tool Kit. Washington. <http://www.iawj.org/wpcontent/uploads/2017/04/Corruption-and-Sextortion-Resource-1.pdf>

¹⁰ Transparency International (2019) Global Corruption Barometer for Latin America and the Caribbean, URL: https://www.transparency.org/files/content/pages/2019_GCB_LatinAmerica_Caribbean_Full_Report.pdf

¹¹ UNDP-Huairou Commission (2012) Seeing beyond the state: Grassroots women's perspectives on corruption and anti-corruption, <https://www.undp.org/content/dam/undp/library/Democratic%20Governance/Anti-corruption/Grassroots%20women%20and%20anticorruption.pdf>

pozitës, ku ka diskrecion nëse do t'i mundësojë apo jo ato të drejta.”¹² Goetz (2007) për shembull thekson se “gratë ballafaqohen me forma të ndryshme të keqpërdorimit dhe sjelljes korruptive nga ana e bartësve të funksioneve publike, sepse valuta e këmbimit që kërkohet nga ata në raport me atë që kërkohet nga burrat është e padukshme”¹³.

“Nëse në funksionet kryesore janë meshkuj, ata zgjedhin të ngjashëm me veten e tyre. Identifikimi zakonisht bëhet me atë që është bartës i pushtetit. Nëse nuk keni grua presidente të shtetit, një grua kryetare e Parlamentit, grua kryeministre, nëse ka vetëm 4 ministra nga 22-23 ministri, nëse ka vetëm dy zëvendësministra, nëse nuk keni grua dekane e Fakultetit të Drejtësisë, identifikimi me të drejtën dhe drejtësinë është më i vështirë. Prandaj unë them se korrupsioni në Republikën e Maqedonisë së Veriut është në gjininë mashkullore. Sidomos në politikë, në administratën shtetërore dhe publike. Sepse nëse shumica e bartësve të funksioneve kryesore janë burra, ata janë të korruptuar.”¹⁴

Në vendet ku nuk ka kuota për pjesëmarrje të garantuar të grave në politikë, studimet tregojnë se zhatja seksuale shfrytëzohet për të fituar pozita në listat zgjedhore të partive¹⁵. Si në të gjitha çështjet gjinore edhe në këtë ekziston premisa fillestare është se korrupsioni dhe në veçanti zhatja seksuale si vepër e korrupsionit ka ndikim të ndryshëm te burrat dhe gratë, e me këtë edhe në statusin e tyre dhe raportin gjinor ndërmjet tyre. Te gratë edhe përgojimi, zëri i ngritur, qoftë edhe i pasaktë për aktivitetin seksual, ndikon ndryshe se sa te burrat, pikërisht për shkak të sistemit patriarkal të familjes dhe mospranimit të sjelljes së lirshme seksuale të grave që nuk është rast te meshkujt. Përgojimet janë të stigmatizuara dhe kontribuojnë që zhatja seksuale të jetë e padukshme si një lloj i korrupsionit¹⁶.

Në vendet ku nuk ka sundim të së drejtës, nuk respektohen rregullat, ku “profesionalizmi dhe kompetencat nuk janë kritere kryesore, rruga profesionale e femrës është më e vështirë sesa ajo e burrit”. Në shoqëritë me nivel të lartë të korrupsionit, me burra në pozitat më të larta, “për të ardhur në pozita të caktuara ose nëse vini aty, për t’u avancuar ose qëndruar, ndonjëherë jeni të detyruar që të bëheni viktimë e zhatjes seksuale”¹⁷.

¹² Natasha Gaber-Damjanovska, Director of the Academy for Judges and Public Prosecutors (Interview 13.09.2021)

¹³ Goetz, Anne Marie (2007). “Political Cleaners: women as the New Anti-Corruption Force?” *Development and Change* 38(1):

¹⁴ Gordana Siljanovska, Kryetare e KMB në Kuvendin e RMV-së (Intervistë më 07.10.2021)

¹⁵ Shih në Bjarnegård 2013; Sundström & Wängnerud 2016

¹⁶ Åsa Eldén, Dolores Calvo, Elin Bjarnegård, Silje Lundgren and Sofia Jonsson (2020) SEXTORTION: CORRUPTION AND GENDER-BASED VIOLENCE, disponueshëm online: https://eba.se/wp-content/uploads/2020/11/Sextortion_webb.pdf

¹⁷ Gordana Siljanovska, Kryetare e KMB në Kuvendin e RMV-së (Intervistë 07.10.2021)



Zhvatja seksuale ka dy lloje të ndikimit:

- (i) tërthorazi në kualitetin dhe kuantitetin e shërbimeve që ofrohen në vend dhe
- (ii) drejtpërdrejt ndaj viktimës së zhvatjes seksuale që mund të rezultojë me përjashtim të vajzave nga arsimi, shtatzëni të padëshiruar, varfërim, e deri te pasojat psikologjike që janë të ngjashme me ato të viktimave të dhunës seksuale.

Kur seksi shfrytëzohet si valutë për të ofruar mitë në këmbim me shërbim “gruaja mund të përjetojë llojin e njëjtë të turpfit që shkaktohet gjatë përdhunimit ose përvojës me një lloj tjetër të dhunës seksuale”¹⁸. Shumë ngjashëm me format brutale të dhunës seksuale, statistikat flasin se cenueshmëria nga zhvatja seksuale është më e madhe te vajzat më të reja.”¹⁹

Prandaj është shumë e rëndësishme që zhvatja seksuale të kuptohet si fenomen gjinor. Krahas burimeve të kufizuara ekzistuese për këtë fenomen, shumica absolute e tyre tregojnë se gratë janë viktima në shumicën e rasteve, të cilat janë keqtrajtuar nga burrat. Kjo nuk nënkupton se kryerësit e kësaj vepre të korrupsionit janë gjithmonë meshkuj, e as se të gjitha viktimat janë femra. Ekzistojnë raste kur burrat dhe djemtë janë viktima të zhvatjes seksuale. Megjithatë për ta kuptuar fenomenin, nevojitet që të kemi njohuri strukturore të normave dhe raporteve gjinore si dhe raporteve ndërmjet gjinisë dhe fuqisë.

¹⁸ International Association of Women Judges (IAWJ) (2012) Stopping the Abuse of Power through Sexual Exploitation. Naming, shaming and ending sextortion. A Tool Kit. Washington. <http://www.iawj.org/wpcontent/uploads/2017/04/Corruption-and-Sextortion-Resource-1.pdf>

¹⁹ Nikolina Kenig, Profesor i rregullt, Fakulteti filozofik (Intervistë 19.08.2021)

Qasja metodologjike në hulumtim

Analiza është bërë duke shfrytëzuar triangulimin e të dhënave primare të fituara nga intervistat dhe diskutimet në grupet e fokusit, të dhënat sekondare përmes hulumtimit të kabinetit të raporteve dhe analizave të institucioneve dhe organizatave tjera, si dhe analizës së kornizës juridike vendore dhe ndërkombëtare.

Analiza ka disa nënkapituj që janë të lidhura me çështjet kryesore për rregullimin e zhvatjes seksuale. E njëjta paraqet bazë për përkufizimin e aktvendimeve që janë prezantuar si rekomandime në kapitullin vijues.

Metodologjia e hulumtimit përbëhet prej tri fazave:

- (I) analiza e rregullativës ekzistuese ligjore,
- (II) analiza krahasuese e kornizës juridike ndërkombëtare dhe
- (III) intervistat dhe grupet e fokusit të gjysmëstrukturuara

Hulumtimi u realizua në periudhën nga qershori deri në tetor të vitit 2021, ndërsa tërë qasja ishte në pajtim me rekomandimet për distancim fizik në periudhën e pandemisë së shkaktuar nga virusi Kovid-19.

Faza I - Analiza e rregullativës ekzistuese ligjore

U bë analizë e legjislacionit kombëtar dhe konventave ndërkombëtare të ratifikuara në shtet, me qëllim për të përcaktuar nëse dhe në cilën mënyrë rregullohen format gjinore të korrupsionit me fokus në zhvatjen seksuale. U analizuan këto ligje kombëtare:

- ✎ Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut
- ✎ Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave
- ✎ Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje
- ✎ Ligji për mundësi të barabarta të burrave dhe grave
- ✎ Ligji për marrëdhënie të punës
- ✎ Ligji për mbrojtjen nga shqetësimi në vendin e punës
- ✎ Ligji për arsim të lartë
- ✎ Ligji për mbrojtjen e denoncuesve



Për nevojat e hulumtimit janë analizuar edhe këto konventa dhe iniciativa ndërkombëtare:

- Konventa e Kombeve të Bashkuara për Luftë kundër Korrupsionit (UNKAK)
- Konventa e së Drejtës Penale për Korrupsion – Këshilli i Evropës (CoE)
- Konventa e së Drejtës Civile për Korrupsion – Këshilli i Evropës (CoE)
- Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalim dhe Luftë kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje – Konventa e Stambollit
- GREKO – Grupi i Shteteve për Luftë kundër Korrupsionit

Faza II – Intervista dhe grupet e fokusit të gjysmëstrukturuara

Për qëllimet e hulumtimit janë realizuar 16 intervista dhe tri grupe të fokusit me faktorë dhe ekspertë relevantë nga sfera e korrupsionit në mesin e të cilëve gjykatës, prokurorë publikë, avokatë, deputete, përfaqësues të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, përfaqësues të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, akademikë dhe përfaqësues të sektorit civil, faktorë të shquar në sferat: lufta kundër korrupsionit, mbrojtja e të drejtave të njeriut, barazia gjinore, pengimi dhe parandalimi i dhunës ndaj grave.

Intervistat dhe grupet e fokusit u realizuan duke shfrytëzuar platformën ZOOM, në pajtim me masat e Qeverisë për mbrojtje nga përhapja e virusit Kovid-19. Lista e faktorëve të intervistuar gjendet në Aneksin I të raportit.


Analiza juridike

Qëllimi i këtij studimi është që të bëhet analizë juridike e kornizës ekzistuese kombëtare, strukturës institucionale dhe nivelit të vetëdijes për rregullim, parandalim dhe mbrojtje nga zvatja seksuale si formë e korrupsionit. Por, që të bëhet analiza nevojitet të vendosen postulatet themelore të veprës si dhe të bëhet dallim ndërmjet zvatjes seksuale dhe llojeve tjera të dhunës me bazë gjinore ku kryerësi i veprës shfrytëzon metoda detyruese si kërcënim ose dhuna fizike për të fituar marrëdhënie seksuale.

Kryqëzimi i korrupsionit dhe dhunës me bazë gjinore

“Zvatja seksuale është padyshim një prej formave më jonjerëzore me specifikë gjinore të korrupsionit. Korniza e jonë ligjore e njeh shqetësimin seksual dhe mobingun si forma të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, përmes rregullave tjera ligjore, por jo edhe përmes Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave.”²⁰

Fillimisht duhet të qartësohet fakti se zvatja seksuale i kryqëzon korrupsionin dhe format e dhunës me bazë gjinore siç janë shqetësimi seksual, eksploatimi seksual dhe keqpërdorimi seksual. Nëse i shohim ligjet që në mënyrë specifike i rregullojnë korrupsionin dhe dhunën me bazë gjinore, do të vërejmë se asnjë prej tyre nuk e njeh zvatjen seksuale si formë të korrupsionit.



²⁰ Lupço Nikolovski, zëvendëskryetar i Qeverisë për luftë kundër korrupsionit dhe krimit, zhvillim të qëndrueshëm dhe resurse njerëzore (Intervistë 08.10.2021)



Gjegjësisht, në mënyrë që vepra e zhatjes seksuale të konsiderohet si korrupsion, nevojitet që të ekzistojë transaksion, respektivisht personi të kërkojë ose pranojë shërbim seksual, e në këmbim të ofrojë diçka që është në kuadër të autorizimeve/detyrës zyrtare të tij/saj. Pa transaksionin në fjalë, vepra është shqetësim seksual ose keqpërdorim seksual. Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje²¹ në listën e nocioneve nga neni 3, paragrafi 1 rregullon “dhunën ndaj grave” si shkelje e të drejtave të njeriut, diskriminimin ndaj grave dhe i shënon të gjitha veprimet e dhunës me bazë gjinore që shkaktojnë ose me gjasë do të shkaktojnë vujtje ose lëndime fizike, seksuale, psikike ose ekonomike të grave, përfshirë edhe kërcënimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta dhe frikësim për veprime të tilla, zhatje, kufizim arbitrar dhe/ose privim nga liria, pa marrë parasysh nëse ndodhin në jetën publike ose private. Por ky ligj nuk e rregullon karakterin e transaksionit të zhatjes seksuale me çka pamundësohet përkufizimi i veprës së zhatjes seksuale si vepër e korrupsionit. Megjithatë me nenin 3, paragrafi 18 bëhet kufizimi i zhatjes seksuale nga dhuna seksuale që ekziston edhe kur detyrohet një person tjetër që të përfshihet në veprime të natyrës seksuale me një person të tretë pa pëlqimin e saj.

Në esencën e veprës së zhatjes seksuale si vepër e korrupsionit, pëlqimi është bazë që vepra megjithëse është e zhvatur me marrje të shërbimit në këmbim. Kjo është me rëndësi sepse ka efekt për ta bërë viktimën bashkëpjesëmarrës. Supozojmë se aspekti i transaksionit deri në një shkallë të caktuar i arsyeton shërbimet seksuale të marra në prezencë të kryerësit, por ndoshta edhe në prezencë të viktimës. Transaksioni, gjithashtu mund të kuptohet si një strategji për uljen e rrezikut nga ana e kryerësit. Me faktin që ofruesi i shërbimeve seksuale do të bëhet bashkëpjesëmarrës dhe duke shfrytëzuar argumentin quid pro quo në vend të detyrimit fizik, rreziku i denoncimit është i minimizuar. Së këndejmë është e rëndësishme që në Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen e grave nga dhuna dhe nga dhuna në familje, është definuar se “pëlqimi patjetër duhet të shprehet vullnetarisht si rezultat i vullnetit të lirë të personit, vlerësimit në kontekst të rrethanave”. Vlerësimi i këtij aspekti varet nga vullneti, vetëdija dhe gatishmëria e gjykatësve për të konstatuar se vepra është kryer duke keqpërdorur fuqinë, detyrën zyrtare, ose funksionin publik, respektivisht se shërbimi seksual është zhvatur si përfitim për të marrë diçka që bartësi i funksionit publik ka qenë i detyruar ta ofrojë, mundësojë, realizojë të drejtë etj. Problemi nuk qëndron vetëm në rregullativën ligjore. Para së gjithash është në perceptimin, normalizimin e këtij lloji të veprimit. Që nënkupton se një numër i madh i njerëzve nuk e kanë pranuar si një sjellje joadekuate por si diçka që duhet të tolerohet, sepse është një lloji i traditës, folklorit, normës.”²²

²¹ Law on Prevention and Protection of Women from Violence and Domestic Violence, available at <https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/2021/1a28a922f364401e94935d4d694b9d75.pdf>

²² Nikolina Kenig, Profesor i rregullt, Fakulteti Filozofik (Intervistë 19.08.2021)

Është interesant fakti që Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen e grave nga dhuna dhe dhuna në familje, tenton që në nenin 3, paragrafi 25 ta përkufizojë “kontrollin e detyrueshëm ndaj grave si **keqpërdorim të fuqisë**, përdorim të kërcënimeve, forcës ose formave tjera për detyrim, mashtrim ose paraqitje të gabuar me qëllim të kontrollimit të sjelljes dhe jetës së grave”, por nuk e përkufizon transaksionin si një element që pamundëson njohjen e veprës së zhatjes seksuale si vepër e korrupsionit në këtë lex specialis. Kjo konfirmohet edhe me nenin 4, paragrafi 1 i cili e rregullon vëmendjen e detyrueshme të organeve të pushtetit shtetëror, personave juridikë që kanë autorizime publike të përcaktuara me ligj, funksionarëve, nëpunësve dhe personave tjerë të autorizuar që kryejnë punë në emër të shtetit, se kanë për obligim që të përmbahen nga pjesëmarrja në veprimet e dhunshme dhe të ndër marrin të gjitha masat dhe aktivitetet për parandalimin e çfarëdo veprimi të dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe dhunës në familje, por nuk e ndalon zhatjen seksuale si këmbim për të kryer detyrën dhe funksionin e tyre publik.

Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen e grave nga dhuna dhe dhuna në familje i rregullon lëndimet dhe vuajtjet seksuale ose psikike të grave, përfshirë edhe kërcënimet dhe frikësimet e drejtpërdrejta dhe tërthorta nga ato veprime, zhatje; por nuk e rregullon karakterin e transaksionit të zhatjes seksuale me çka pamundësohet përkufizimi i veprës si vepër e korrupsionit.

Megjithatë rregullimi i pëlqimit si rezultat i vullnetit të lirë të personit, në kontekst të rrethanave, mundëson që të dëshmohej se shërbimi seksual është zhvatur si përfitim në këmbim me diçka të cilën bartësi i funksionit publik është i obliguar që ta ofrojë, mundësojë, të realizojë të drejtë etj.

Por pa një ndalim konkret të zhatjes seksuale, me këtë lex specialis nuk rregullohet shkëlja, nuk parashihen masa parandaluese, e as mbrojtje nga ky lloj i keqtrajtimit të grave.

Në ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave²³ mungojnë elemente në përkufizimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave për ta njohur zhatjen seksuale si vepër të korrupsionit. Neni 2 paragrafi 1 definojnë se “me korrupsion në kuptim të këtij ligji, nënkuptohet keqpërdorimi i funksionit, autorizimit publik, detyrës zyrtare ose pozitës për realizimin e dobisë, drejtpërdrejt ose përmes ndërmjetësuesit, për veten ose dikë tjetër”. Dobia, më vonë në nenin 8 paragrafi 1, definohet si “realizim i secilit lloj të përfitimit, volitshmërisë, përparësisë materiale ose jomateriale për vete ose dikë tjetër”. Së këndejmë, megjithëse në mënyrë specifike nuk është rregulluar, seksi mund të shqyrtohet si përfitim jomaterial. Megjithatë nëse i shohim nenet nga Kreu pesë i Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, e që kanë të bëjnë me parandalimin e korrupsionit gjatë kryerjes së autorizimeve publike, nuk do të gjejmë ndalim për pranimin ose zhatjen e shërbimeve seksuale për të kryer ndikim të caktuar ndaj kryerjes objektive dhe të paanshme të funksioneve, autorizimeve publike ose detyrave zyrtare. Si rezultat i kësaj, nuk ekzistojnë as dispozita të kundërvajtjes me të cilat do të ndëshkohej zhatja seksuale si vepër e korrupsionit. Në fakt, Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave

²³ Law on Prevention of Corruption and Conflict of Interests, available at https://www.dksk.mk/fileadmin/user_upload/Zakon_z_a_sprecvanje_na_korupcija_i_sudiro_t_na_interesi.pdf



me nenin 3 ku rregullohet parimi i ligjshmërisë, e pamundëson inicimin e procedurës për parandalimin e korrupsionit me zvatje seksuale sepse në nenin 3 rregullohet se “askush nuk mund të thirret në përgjegjësi për korrupsion, përveç në rastet dhe kushtet e parapara me këtë ligj, me Kodin Penal dhe me ligjet tjera dhe në procedurë të përcaktuara me ligj”; duke marrë parasysh faktin se zvatja seksuale nuk është e ndaluar me këtë ligj.

Ligji për arsimin e lartë, në nenin 27 e rregullon të drejtën e studentit që të mbrojtë të drejtat dhe obligimet e veta para organeve të institucionit të arsimit të lartë dhe të drejtën e mbrojtjes së personalitetit të studentit nga keqpërdorimi dhe dinjitetit të tij. Denoncimi bëhet te personi i autorizuar për pranimin e kallëzimeve të korrupsionit të cilat si forma dhe dukuri nuk janë të përcaktuara me nenin 107 të Ligjit për arsimin e lartë.

Kur kjo ndodh në vendin e punës, shpeshherë është dilema vallë nëse denoncohet zvatja seksuale nga një epror, denoncuesja do të pushohej nga vendi i punës. Kjo në mënyrë shtesë komplikohet gjatë ekzistimit të diksrecionit të pamjaftueshëm nga denoncimi. Shqyrtimi i rregullativës nacionale ligjore e cila për momentin pjesërisht e rregullon zvatjen seksuale si formë të korrupsionit, tregon se Ligji për marrëdhëniet e punës²⁴ e rregullon Ndalimin e diskriminimit në Nenin 6 në bazë të gjinisë dhe moshës, duke përcaktuar se Punëdhënësi nuk guxon që kërkuesin e punës (në tekstin e mëtejme: kandidatin për punësim) ose punëtorin, ta vë në pozitë të pabarabartë (paragrafi 1); respektivisht se grave dhe burrave patjetër duhet t’u sigurohen mundësi të barabarta dhe trajtim të njëjtë gjatë punësimit, avancimit në punë, aftësimin, arsimimit, rikualifikimit, në pagat, në shpërblimet, gjatë mungesës në punë, kushteve të punës, në orarin e punës dhe anulimin e kontratës për punësim (paragrafi 2).

Në kontekst të punësimit, quid pro quo shqetësimi seksual paraqitet kur përfitimi ose dëmi për punësim kushtëzohet nga përgjigjja e punëtorit lidhur me kërkesën seksuale. Zvatja/sekstoricioni seksual përfshin të njëjtin shkëmbim, por nuk është i kufizuar vetëm me vendin e punës. Shërbimi seksual në këmbim me ndonjë dobi që personi në pozitë të fuqisë nuk e ndan ose për ta ndarë – është faktori kryesor për ekzistimin e komponentit korruptues të sekstoricionit. Shqetësimi dhe shqetësimi gjinor janë të rregulluara dhe

Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave është shkruar me nocione mjaft të gjëra që mund ta përfshijnë mitën/ryshfetin në formë jomateriale për realizimin e volitshmërisë, përfitimit, ose përparësisë për veten ose dikë tjetër. Megjithatë mungesa e ndalimit specifik të zvatjes seksuale si vepër e korrupsionit lë hapësirë tepër të gjerë për interpretime në procedurën e denoncimit dhe dëshmisë së korrupsionit, ndonjëherë varësisht edhe nga kuptimi dhe vullneti i anëtarëve të Komisionit për Mbrojtje dhe Parandalim të Korrupsionit, si dhe instancave gjyqësore.

²⁴ Ligji për marrëdhëniet e punës („Gazete zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 62/2005; 106/2008; 161/2008; 114/2009; 130/2009; 149/2009; 50/2010; 52/2010; 124/2010; 47/2011; 11/2012; 39/2012; 13/2013; 25/2013; 170/2013; 187/2013; 113/2014; 20/2015; 33/2015; 72/2015; 129/2015 dhe 27/2016, ne dispozicion online https://mtsp.gov.mk/content/pdf/trud_2017/pravilnici/16,11-%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D0%A0%D0%B0%D0%B1%D0%9E%D0%B4%D0%BD%D0%BE%D1%81%D0%B8.pdf

të ndaluara me Nenin 9 të Ligjit për marrëdhënie pune dhe janë të kategorizuara si diskriminime në kuptim të nenit 6 të ligjit.

Por përkufizimi i shqetësimit vetëm si “sjellje e padëshiruar që ka për qëllim ose paraqet shkelje të dinjitetit të kandidatit për punësim ose punëtorit, e cila shkakton frikë ose krijon sjellje të pakëndshme, nënçmuese ose ofenduese”; nuk mjafton për të përfshirë elementet e zhatjes seksuale.

Konventa 190²⁵ e Organizatës Ndërkombëtare të Punës që ka të bëjë me dhunën me bazë gjinore në vendet e punës i obligon vendet nënshkruese që të identifikojnë, në konsultim me organizatat e interesuara të punëdhënësve dhe punëtorëve dhe përmes mjeteve tjera, sektorët ose sipërmarrësit dhe arranzhmanet e punës ku punëtorët dhe personat tjerë janë më shumë të ekspozuar ndaj dhunës dhe shqetësimit; dhe të ndërmarrin masa për mbrojtje efektive për ato persona.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut ekzistojnë ligje që mund të shfrytëzohen për përndjekjen dhe parandalimin e keqpërdorimit të fuqisë për të zhatur marrëdhënie ose shërbime seksuale. Ligji për marrëdhënie pune (LMP) nuk është një prej tyre. Nevojitet harmonizimi i LMP-së me Konventën 190 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës.

Ligji për mbrojtjen nga shqetësimi në vendin e punës²⁶ në Nenin 5, paragrafi 2 e rregullon shqetësimin gjinor si çdo sjellje verbale, jo verbale ose fizike me karakter gjinor, që ka për qëllim ose paraqet shkelje të dinjitetit të kandidatit për punësim ose punëtorit, e që shkakton ndjenjë të frikës ose të pakëndshme, nënçmuese. Sjellja e tillë konsiderohet si psikike, respektivisht shqetësim gjinor në vendin e punës nëse nuk ka pushuar edhe pas vërejtjes me shkrim nga ana e personit të shqetësuar se i pengon sjellja e kryerësit të shqetësimit dhe se do ta konsiderojë si shqetësim në vendin e punës. Në këtë aspekt Ligji nuk është bazë e mjaftueshme që të cilësohet zhatja seksuale si mjet korruptues që mjafton të ndodhë njëherë. Zakonisht zhatësi një herë jep kusht të tillë, ku viktimat pranon, nuk pranon ose e denoncon; kurse sipas Ligjit për mbrojtje nga shqetësimi në vendin e punës, veprimi patjetër duhet të ketë përsëritje dhe së këndejmë kërkohet edhe kërkesë me shkrim për të mos u përsëritur, në mënyrë që kjo veper të kualifikohet si shqetësim gjinor. Nuk përfshin tentim për zhatje seksuale, mund të përsëritet oferta, por edhe nuk është patjetër.

²⁵ C190 – Konventa për dhunë dhe shqetësim, e disponueshme online: https://www.ilo.org/dyn/normlex/en/f?p=NORMLXPUB:12100:0:NO:P12100_ILO_CODE:C190

²⁶ Ligji për mbrojtje nga shqetësimi në vendin e punës („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë “ nr. 79/2013 и 147/2015), i disponueshëm online: https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/trud_2017/pravilnici/16,,11-%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D0%97%D0%B0%D1%88%D1%82%D0%B8%D1%82%D0%B0%D0%92%D0%BE%D0%B7%D0%A0%D0%B0%D0%B1%D0%9C%D0%B5%D1%81-%D1%82%D0%BE.pdf



Më tutje në nenin 7 të Ligjit në paragrafin 3 rregullohet që si kohë për kryerje të shqetësimit psikik dhe gjinor në vend të punës, konsiderohet koha në kuadër të orarit të punës dhe kohës së udhëtimit nga dhe deri në vendin e punës, kur është kryer lloji dhe mënyra e sjelljes që konsiderohet si shqetësim në vendin e punës. Por zhatja seksuale mund të kryhet edhe jashtë vendit dhe orarit të punës, veçanërisht nëse bëhet fjalë për punësim. Së këndejmë Ligji për mbrojtje nga shqetësimi në vendin e punës nuk paraqet kornizë të mjaftueshme për njohjen, parandalimin dhe mbrojtjen nga zhatja seksuale si vepër e korrupsionit. Sipas praktikuesve, ky ligj në mënyrë taksative i numëron rastet ku mund të shihet shqetësimi që e bën procesin e mbrojtjes tërësisht të varur nga vetëdija e gjykatësve dhe kapaciteti për të njohur mobingun dhe diskriminimin. Avokatja Marta Gusar konsideron se “ose gjykatësit nuk janë mjaftë të trajnuar për të parë atë ose ligji nuk është i mirë. Duhet të ekzistojë diçka që mund të jetë realisht e zbatueshme në praktikë. Zhatja seksuale duhet të arsyetohet në më shumë detaje dhe me një pasqyrim më të gjerë në mënyrë që të mund të zbatohet.”

Përcaktimi terminologjik dhe raporti kryerës-viktimë e zvatjes seksuale

Që të rregullohet vepra në mënyrë efektive, është me rëndësi që për këtë vepër të përdoren nocionet **kryerës i zvatjes seksuale** dhe **viktimë e korrupsionit**, si dhe të mos zëvendësohen me nocione tjera si p.sh. pranues dhe ofrues i mitës, ose padroni dhe klienti; me çka do të pamundësohet përzjerja e veprës me veprat tjera. Këtu i përfshijmë edhe nocionet dhunues dhe viktimë e dhunës si të parekomanduara në mënyrë që të bëhet dallim ndërmjet veprës dhe veprave tjera të ngjashme të dhunës me bazë gjinore. Shfrytëzimi i këtyre nocioneve – kryerësi i zvatjes seksuale dhe viktimë e korrupsionit është rekomanduar edhe në raportet e Asociacionit Ndërkombëtar të Grave Gjykatëse²⁷ dhe të Asociacionit Ndërkombëtar të Avokatëve²⁸.

Gjithashtu duhet të merret parasysh se nocionet kryerës i zvatjes seksuale dhe viktimë, shfrytëzohen në formë neutrale gjinore dhe mund të aplikohen edhe për burra edhe gra në rolin e kryerësve dhe viktimave. Nuk duhet të kufizohet në mënyrë eksplicite që viktimë të jetë vetëm grua. Në disa sisteme juridike si p.sh. në Indi ajo bëhet, por paraqet kufizim. Hulumtimet tregojnë se pjesa më e madhe e viktimave janë gra, por ekzistojnë edhe raste kur si viktimë paraqiten edhe burrat. Gjithashtu nuk guxojmë që të harrojmë se kryerësi i zvatjes seksuale mund të jetë edhe një grua në pozitë të fuqishme. Kryerësi i veprës së zvatjes seksuale, bën eksploatim në aspekt të fuqisë, shpeshherë në raport me asimetrinë gjinore, dhe gjithmonë në raport me autoritetin e besuar të pozitës në të cilën është emëruar, përkatësisht e kryen si nëpunës shtetëror. Mosbalancimi i fuqisë ndërmjet palëve të përfshira në veprën e zvatjes seksuale, përgjegjësia për aktin patjetër duhet të vihet te personi që e ka keqpërdorur pozitën dhe autorizimin e besuar nga ana e shtetit²⁹. Kjo analogji për rregullim eksplicit të gjinisë së viktimës duhet të vlejë edhe për kryerësin/kryerësen.

Kjo është me qëllim të shmangies së kriminalizimit të viktimës si ofrues i shërbimeve seksuale dhe të jetë edhe pjesëmarrës në vepër. Së këndejmë duhet të bëhet dallim i konsiderueshëm ndërmjet veprave të dhënies dhe marrjes së mitës dhe veprës së zvatjes seksuale. Veçanërisht sepse në legjislacionin maqedonas me veprën e dhënies

²⁷ International Association of Women Judges (IAWJ) (2012) Stopping the Abuse of Power through Sexual Exploitation. Naming, shaming and ending sextortion. A Tool Kit. Washington. <http://www.iawj.org/wp-content/uploads/2017/04/Corruption-and-Sextortion-Resource-1.pdf>

²⁸ International Bar Association - IBA. 2019. Sextortion: A crime of corruption and sexual exploitation

²⁹ Åsa Eldén, Dolores Calvo, Elin Bjarnegård, Silje Lundgren and Sofia Jonsson (2020) SEXTORTION: CORRUPTION AND GENDER-BASED VIOLENCE, достапно онлајн: https://eba.se/wp-content/uploads/2020/11/Sextortion_webb.pdf



së mitës, roli i dhënësit është i kriminalizuar. Neni 358 nga Kodi Penal³⁰ në paragrafin 1 rregullon se “ai i cili personit zyrtar drejtpërdrejt ose tërthorazi do t’i japë, premtojë ose ofrojë dhuratë ose dobi tjetër për të ose dikë tjetër, për të kryer veprim zyrtar që nuk do të guxonte ta kryejë ose që të mos kryejë veprim zyrtar të cilin duhet patjetër ta kryejë, ose të ndërmjetësojë për këtë, do të dënohet me burg prej një deri në pesë vite. Meqë në teori, ligjet e analizuara më lart: Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen e grave nga dhuna dhe dhuna në familje dhe Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, japin një bazë mjaftë të gjerë për përndjekjen e kësaj vepre, por mundësojnë edhe rrezikun që viktima e zhatjes seksuale të ndiqet penalisht, nevojitet që të definohet një vepër e posaçme penale për zhatjen seksuale dhe e njëjta si nocion të definohet edhe në Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave. Nëse viktima ndiqet penalisht, ekziston rreziku që zhatja seksuale të mos denoncohet.

Gjithsesi nevojitet që të merren parasysh disa aspekte. Së pari, për shkak të rregullativës ekzistuese e cila e rregullon ekzistimin e pëlqimit që vepra të kryhet nga kryerësi dhe natyra e veprës do të vështirësojë që të dëshmohet mungesa e pëlqimit në këmbim me quid pro quo me të cilën karakterizohet vepra. Së dyti, duke marrë parasysh që zhatja seksuale bazohet në detyrimin psikik dhe pozitën e fuqisë që e shfrytëzon kryerësi në raport me viktimën, e jo me forcë fizike, detyrim, kërcënime fizike etj., do të dëshmohet vështirë se viktima është frikuar për jetën e vet dhe se ka mundur që edhe të lëndohet. Prandaj është me rëndësi që legjislacioni ta rregullojë raportin e fuqisë ndërmjet kryerësit të zhatjes seksuale dhe viktimës.

„Zhatja seksuale ose sektorcioni si e tillë nuk është prezent në Kodin Penal, por ndoshta duhet të mendohet se në cilën mënyrë duhet të përcaktohet në aspekt të detyrimit nga pozita e fuqisë”.³¹ Duke marrë parasysh se zhatja seksuale rekomandohet që të rregullohet si vepër penale, e njëjta duhet ta ndjekë standardin për t’u dëshmuar sikurse edhe deliktet tjera seksuale, ku barra e dëshmisë është te i akuzuari, ndërsa përveç deklaratës së viktimës, përfshin edhe argumente tjera konfirmuese.

Në këtë kontekst rekomandohet: (i) përkufizimi i zhatjes seksuale si vepër penale; (ii) rregullimi i raportit të fuqisë ndërmjet palëve në veprën e zhatjes seksuale; (iii) rregullimi i të dy palëve kryerës i zhatjes seksuale dhe viktimë e zhatjes seksuale; dhe (iv) rregullimi i barrës për të dëshmuar pafajësinë e palës së akuzuar si kryerëse e zhatjes seksuale.

³⁰ Kodi penal, mund të merret në <https://www.slvesnik.com.mk/Issues/6ed04b3db86643b297d84aa94513d055.pdf>

³¹ Natasha Gaber-Damjanovska, Drejtoreshë e Akademisë së Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë (Intervistë 13.09.2021)

Përgjegjësia kundërvajtëse ose penale?

Studimi i Asociacionit Ndërkombëtar të Gjykatëseve prezanton katër udhëzime përmes të cilave rregullohet zhvatja seksuale, dhe sigurohet në aspekt juridik parandalimi dhe mbrojtja nga ky fenomen. Njëri udhëzim është përmes rregullativës së antikorruptonit, udhëzimi i dytë është përmes rregullativës e cila e pengon dhe mbron nga dhuna me bazë gjinore; udhëzimi i tretë është përmes rregullativës për antidiskriminim dhe shqetësim seksual në marrëdhëniet e punës. Të gjitha këto udhëzime parashohin përgjegjësi kundërvajtëse të kryerësit të veprës. Në pak raste rregullohet qartazi si vepër penale. Ato janë Kodi Penal i Tajvanit që në kuadër të veprave kundër moralit në mënyrë eksplicite e kriminalizon “keqpërdorimin e pozitës së autoritetit për zhvatjen e marrëdhënies seksuale në kontekste të ndryshme, përfshirë edhe kryerjen e funksionit publik, punësimin, arsimin ose lidhur me rojtar/kujdestar”³². Edhe në Rumani, keqpërdorimi i fuqisë për përfitime seksuale është i kriminalizuar në mënyrë eksplicite në Kodin Penal, ndërsa ai që ofron shërbime seksuale për nëpunësin publik i cili e shfrytëzon situatën e fuqisë dhe pozitën autoritare që i është besuar, si shkelje³³.

Kodi Penal i Maqedonisë së Veriut³⁴ në **Kreun e nëntëmbëdhjetë: veprat penale kundër lirisë gjinore dhe moralit gjinor** rregullon Abuzimin seksual duke keqpërdorur pozitën në nenin 189 si “ai i cili duke keqpërdorur pozitën e tij do të detyrojë në abuzim seksual ose veprim tjetër gjinor një person ndaj të cilit në raport me të është në gjendje të vartësisë ose varësisë, ose me të njëjtin qëllim e keqtrajton, frikëson ose ndaj tij vepron në mënyrë me të cilën e nënçmon dinjitetin dhe personalitetin njerëzor, do të dënohet me burg prej së paku pesë vitesh” Vepra e definuar në këtë mënyrë e rregullon raportin e fuqisë dhe më saktë vartësisë ose varësisë së viktimës, marrëdhënien seksuale si rezultat i zhvatjes, si dhe pozitën në të cilën gjendet personi (megjithëse nuk është e theksuar në mënyrë specifike se bëhet fjalë për bartës të pozitës publike ose pozitës së nëpunësit shtetëror që ka rëndësi për esencën e veprës së zhvatjes seksuale). Megjithatë, vepra e definuar në këtë mënyrë ka kufizim sepse në përkufizim mungon transaksioni “diçka për diçka” gjë që është kryesore për esencën e veprës së zhvatjes seksuale.

Edhe në Kreun e tridhjetë gjatë rregullimit të veprave penale kundër detyrës zyrtare rregullohet Keqpërdorimi i pozitës dhe autorizimit zyrtar me nenin 353 “Personi zyrtar i cili duke shfrytëzuar pozitën dhe autoritetin e tij zyrtar, duke tejkalluar kufijtë e autorizimit të tij zyrtar dhe duke mos realizuar detyrën e tij zyrtare, do të marrë për vete ose dikë tjetër ndonjë dobi ose do ta dëmtojë dikë tjetër, do të dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vite” Vepra e definuar në këtë mënyrë, i ka elementet e keqpërdorimit të pozitës dhe autorizimit zyrtar, por mungon zhvatja e shërbimit seksual si përfitim, përparësia dhe dobia të cilën e realizon personi zyrtar, e që është element kryesor për esencën e veprës së zhvatjes seksuale.

³² Taiwan legislation available at <https://www.lexadin.nl/wlg/legis/nofr/oeur/lxwetai.htm>

³³ Criminal Code of Romania, available at https://www.legislationline.org/download/id/8291/file/Romania_Penal%20Code_am2017_en.pdf

³⁴ Kodi penal, mund të merret në <https://www.slvesnik.com.mk/Issues/6ed04b3db86643b297d84aa94513d055.pdf>



Vepra e marrjes së mitës e rregulluar në Nenin 357 është më së afërmi me esencën e veprës së zhatjes seksuale sepse rregullon se “personi zyrtar i cili do të kërkojë ose pranojë drejtpërdrejt ose tërthorazi dhuratë ose dobi tjetër ose do të pranojë premtim për dhuratë ose dobi tjetër për vete ose dikë tjetër, për të kryer veprim në kuadër të autorizimit të tij zyrtar, që nuk do të guxonte ta kryente, ose të mos kryejë veprim zyrtar të cilin patjetër duhet të kryejë, do të dënohet me burgim prej katër deri në dhjetë vite.” Problemi është në përkufizimin e dobisë në Kodin Penal që është e rregulluar edhe si: (i) dobi, vlerë ose dëm i vogël pronësor, nënkuptohet si dobi, vlerë ose dëm që përputhet me shumën e gjysmës së pagës mesatare mujore të publikuar zyrtarisht në Republikë, në kohën e kryerjes së veprës; (ii) dobi, vlerë ose dëm më të madh pronësor, nënkuptohet dobia, vlera ose dëmi që përputhet me shumën e pesë pagave mesatare mujore në Republikë, në kohën e kryerjes së veprës; (iii) dobi, vlerë ose dëm i konsiderueshëm pronësor, nënkuptohet dobia, vlera ose dëmi që përputhet me shumën e 50 pagave mesatare mujore në Republikë, në kohën e kryerjes së veprës; dhe (iv) dobi, vlerë ose dëm në përmasa të mëdha nënkupton dobinë, vlerën ose dëmin që përputhet me shumën e 250 pagave mesatare mujore në Republikë, në kohën e kryerjes së veprës. Megjithatë, të gjitha këto përkufizime japin vlerë financiare ose pronësore të dobisë dhe asnjëra prej tyre nuk përfshin marrëdhënien seksuale si përfitim, dobi ose përparësi e cila mund të realizohet. Kjo konsiderohet si rezultat i orientimit të përgjithshëm ndaj korrupsionit që të trajtohet si fenomen ekonomik, që i vështirëson akoma më shumë përpjekjet për t’u ballafaquar me zhatjen seksuale.

Asociacioni Ndërkombëtar i Gjykatëseve prapë se prapë konsideron se vepra e zhatjes seksuale duhet të rregullohet si vepër e korrupsionit duke sugjeruar se “Fuqia detyruese e autoritetit që i karakterizon rastet e zhatjes seksuale është pikërisht lloji i detyrimit që gjendet në rastet e korrupsionit” (IAWJ 2012: 16) Trajtimi i zhatjes seksuale si korrupsion, sugjeron IAWJ, ndihmon që të mënjanohej sfidat e përndjekjes sipas ligjeve që kanë të bëjnë me dhunën me bazë gjinore, veçanërisht në çështjet e detyrimit dhe pajtimit (njësoj).

Procedura e denoncimit dhe veprimi

Denoncimi i zvatjes seksuale është çështje e posaçme për shqyrtim, për shkak të specifikës dhe situatës së ndjeshme në të cilën gjendet viktimja e zvatjes seksuale. Veprimi nga ana tjetër, meqë mund të shkaktojë dëm më të madh, stigmatizim dhe marginalizim të viktimave të cilat edhe pa atë janë të cenueshme dhe të marginalizuara, duhet në mënyrë plotësuese të rregullohet me kujdes. Procedura e denoncimit duhet doemos të sigurohet të jetë e përgjegjshme në aspekt gjinor duke mos shkaktuar shkelje të së drejtave të viktimave. Në legjislacionin maqedonase **Ligji për mbrojtjen e denoncuesve** në Nenin 1 rregullon denoncimin e mbrojtur, të drejtat e denoncuesve, si dhe veprimin dhe obligimet e institucioneve, respektivisht personave juridikë lidhur me denoncimin e mbrojtur dhe sigurimin e mbrojtjes së denoncuesve. Megjithatë ky ligj nuk ka perspektivë gjinore, por mund të plotësohet në mënyrë që të mundësojë **mekanizma me ndjeshmëri gjinore për denoncim** të zvatjes seksuale.

Veprimi i Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit lidhur me denoncimet e korrupsionit është e rregulluar me Nenin 23, paragrafi 1 si procedurë e cila fillon ose me iniciativë personale të KSHPK-së ose në bazë të denoncimit të marrë. KSHPK-ja vepron edhe përmes mbledhjes së të dhënave dhe informatave nga institucionet kompetente, personat juridikë dhe fizikë, duke shfrytëzuar rrjetin e personave të obliguar për antikorruption në institucionin i cili i ndërmerr të gjitha masat dhe aktivitetet për dorëzimin e informatave të kërkuara dhe të njëjtat i dorëzon më së voni në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së kërkesës nga ana e Komisionit Shtetëror (paragrafi 3). Në rastin e mosveprimit ndaj kërkesës, Komisioni Shtetëror mund të iniciojë procedurë për kundërvajtje (paragrafi 4).

Megjithatë denoncimi në të dyja rastet dhe në bazë të Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve dhe Ligjit për parandalimin e korrupsionit duhet të garantojë se informatat e besuara do të ruhen dhe nuk do të shpërndahen. Privatësia e denoncimit është çështje kryesore sepse ndikon në faktin nëse do të denoncohet vepra. Në këtë aspekt, hulumtimet tregojnë se viktimat frikohen që të denoncojnë, në mënyrë që të mos akuzohen dhe turpërohen për keqtrajtimet kur kanë qenë viktimja. Në disa raste ato akuzojnë edhe nga familjet e tyre, miqtë ose institucionet që e procedojnë rastin. “Kur bëhet fjalë për vepër penale, procedura është më afatgjatë, duhet shumë kohë, kalon nëpër shumë faza, në fillim shkohet në polici, pastaj në prokurori publike, riviktimizimi ndodh vazhdimisht”³⁵. Vetakuzimi gjithashtu mund të jetë faktor për mbrojtje efektive nga zvatja seksuale e viktimave sipas Feigenblatt³⁶. Kjo është rezultat edhe e stigmës së zgjeruar lidhur me të gjitha deliktet seksuale/gjinore që i vështirëson ato për denoncim dhe dëshmi. Ekzistimi i mekanizmave që kanë ndjeshmëri gjinore si p.sh. personi që e pranon denoncimin të jetë

³⁵ Marta Gusar, Avokate (Intervistë 25.08.2021)

³⁶ Feigenblatt, Hazel (2020) Breaking the silence around sextortion. The links between power, sex and corruption, Transparency International, Berlin, Germany. Report published 5 March 2020. https://www.transparency.org/whatwedo/publication/breaking_the_silence_around_sextortion



femër, e cila është e trajnuar për barazi gjinore dhe di të veprojë me viktimat e delikteve seksuale. “Mungesa e grave në pozita kryesore i dekurajon që të flasin për diçka që të gjithë e dimë se është realitet, megjithatë hesitim”³⁷

Në procedurën fokusi duhet të vihet te personi i cili në “pozitë të fuqisë, pa dallim nëse bëhet fjalë për punëtor sporteli ose drejtor në ndërmarrje, person që punon në administratë shtetërore ose udhëheqës”. Në atë moment paraqitet se ai është personi i cili duhet ta kryejë punën andaj pozicionohet në atë mënyrë për të marrë ndonjë shërbim seksual”³⁸. “Pozita e fuqisë definon se kush është viktimë. Çfarë do të thotë fuqia, atë mund ta definojmë në shumë mënyra të ndryshme, e që jo gjithmonë njihet, ndonjëherë edhe vetë gjinia është burim i fuqisë.”³⁹

Procedura patjetër duhet të udhëhiqet me kujdes, meqë gjatë dëshimit, për shkak të sistemit patriarkal të raporteve gjinore “nga njëra anë viktimat akuzohen si dikush që vetë e kërkojnë, kanë një pjesë të madhe të përgjegjësisë, nëse jo edhe përgjegjësi të plotë të situatës në të cilën gjenden; kurse nga ana tjetër, trajtohet vetë lloji i presionit/detyrimit si më pak i rëndësishëm sesa kur kërkohen para, hua ose avancime profesionale.”⁴⁰ Kjo është rezultat i vetë konceptimit të korrupsionit si një fenomen ekonomik i cili manifestohet me përfitime ekonomike ose financiare, andaj shërbimi seksual si përparësi, dobi, përfitim, denominohet si jo mjaft i rëndësishëm, që fitohet nga raporti quid pro quo ndërmjet viktimës dhe bartësit të korruptuar të funksionit publik/nëpunësit shtetëror. Madje edhe në sistemet ku zvatja seksuale është e rregulluar, vetëdija e gjykatësve, prokurorëve publikë është ende e ulët për shkak të logjikës ekonomike të rregullimit të korrupsionit.

Gjatësia e procedurës gjithashtu duhet të përshtatet. Gjatë delikteve seksuale për reduktimin e kohës së veprimit dhe ridërgimit të viktimës nga një institucion në një tjetër dhe për të ulur rrezikun e riviktimizimit nga ana e institucioneve që veprojnë veçanërisht nëse ato nuk kanë ndjeshmëri të mjaftueshme për nevojat dhe të drejtat e grave. Procedura duhet të përfshijë edhe përkrahjen psikologjike të viktimës si dhe ofrimin e përkrahjeve tjera përfshirë edhe ndihmën juridike falas.

Nëse nxiten viktimat e këtij lloji të korrupsionit për t'i denoncuar ato punë që ju ndodhin ndoshta në praktikë edhe do të punojmë me më shumë lëndë të tilla. Sepse sinqerisht dhe realisht mendoj se ajo na ndodh në realitet mirëpo si numër ende hyn si numër i errët në kuadër të krimit të pazbuluar.”⁴¹. Prokurorja Publike Raiçeviq e cila ka punuar në ras-

³⁷ Gordana Siljanovska, Kryetare e KMB të Kuvendit (Intervistë 07.10.2021)

³⁸ Marta Gusar, Avokate (Intervistë 25.08.2021)

³⁹ Nikolina Kenig, profesoreshë ordinere, Fakulteti Filozofik (Intervistë 19.08.2021)

⁴⁰ Nikolina Kenig, profesoreshë ordinere, Fakulteti Filozofik (Intervistë 19.08.2021)

⁴¹ Gabriela Gajdova, Gjykatëse, Gjykata Themelore në Veles (Intervistë 23.09.2021)

tin kur profesorët e Fakultetit Ekonomik ishin të akuzuar për korrupsion, potencoi se profesorët akuzohen vetëm për marrje të mitës dhe për kryerje të ndikimeve të paligjshme. Megjithëse vepra e dy profesorëve ka elemente të zhatjes seksuale, komponenti seksual nuk është marrë parasysh dhe për të nuk do të përgjigjen. Kjo nuk do të kontribuojë që të tejkalohet frika për denoncimin e zhatjes seksuale dhe mund vetëm që të rritet frika për stigmatizimin e viktimave tanimë të cënueshme të kësaj veprë të korrupsionit.

Në këtë kontekst rekomandohet: (i) përkufizimi i kujdesshëm i denoncimit nga ana e viktimës së zhatjes seksuale si vepër penale; (ii) rregullimi i procedurës që të jetë më e shkurtër për shkak të uljes së rrezikut nga riviktimizimi; (iii) rregullimi i shërbimeve për përkrahjen e viktimës.



Konteksti ndërkombëtar

Analiza e konventave dhe iniciativave ndërkombëtare

Sekstorcioni (sextortion/sexual extortion) respektivisht zhvatja seksuale si nocion nuk mund të haset në konventat ndërkombëtare për luftë kundër korrupsionit, para së gjithash për shkak të mungesës së perspektivës gjinore dhe shfrytëzimit të qasjes neutrale gjinore në parandalimin dhe pengimin e korrupsionit. Megjithatë për shkak të shtrirjes së gjerë të veprimeve korruptuese materiale dhe jomateriale, ekziston hapësirë për përfshirjen e veprës nën veprimet korruptuese që janë të rregulluara me këto konventa.

Konventa e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) për Luftë kundër Korrupsionit

Konventa e OKB-së për Luftë kundër Korrupsionit⁴² (UNKAK) është miratuar në vitin 2003 nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, e cila ka hyrë në fuqi në vitin 2005 kur edhe Republika e Maqedonisë së Veriut i qaset të njëjtës, e të cilën e ratifikon në vitin 2007. Kjo Konventë është instrument i vetëm i obligueshëm global ndërkombëtar kundër korrupsionit. Tri qëllimet kryesore të Konventës janë:

- Promovimi dhe përforcimi i masave për parandalimin dhe pengimin efektiv dhe efikas të korrupsionit;
- Promovimi, realizimi dhe përkrahja e bashkëpunimit ndërkombëtar, përfshirë edhe përkrahjen teknike në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit;
- Promovimi i integritetit, përgjegjësisë dhe udhëheqjes së drejtë me punët dhe pronësinë publike.

Konventa parasheh që secili shtet anëtar të miratojë masa ligjore dhe masa tjera të cilat janë të domosdoshme që veprimet korruptuese të shihen si vepra penale, kur kryhen qëllimisht, e me këtë obligohet edhe Republika e Maqedonisë së Veriut.

⁴² Konventa e OKB-së për luftë kundër korrupsionit, mund të merret në <https://customs.gov.mk/images/documents/borbaKorupcija/oonProtivKorupcija.pdf>

Megjithëse në këtë Konventë nuk shfrytëzohet perspektivë gjinore gjatë udhëzimeve për inkriminimin e formave të korrupsionit, në kapitullin III-Kriminalizimi dhe zbatimi i ligjit, në nenin 15 që i rregullon format e marrjes së mitës së nëpunësve publikë kombëtarë, zhatjes seksuale, respektivisht sekstorcionit të kryer nga nëpunësit publikë mund të interpretohet me paragrafin B të Konventës si vijon:

“(b) Kërkimi ose pranimi nga ana e nëpunësit publik, drejtpërdrejt ose tërthorazi, për përparësi joadekuate, për vetë nëpunësin ose për person ose subjekt tjetër, me qëllim personi zyrtar të veprjë ose të përmbahet nga veprimi i kryerjes së detyrave dhe obligimeve të tij ose të saj zyrtare”⁴³

Përkufizimi i vendosur në këtë mënyrë e anashkalon komponentin seksual të veprës së zhatjes seksuale dhe sanksionimin e bazon në komponentin korruptues. Keqpërdorimi i fuqisë është paraparë gjithashtu si vepër penale me këtë Konventë, por definicioni është përsëri i gjerë dhe nuk i thekson në mënyrë eksplicite të gjitha normat e keqpërdorimit të fuqisë, por le që shtetet anëtare të vlerësojnë se çfarë duhet të përfshihet me “përparësi joadekuate”.

Konventa e së Drejtës Penale për Korrupsion e Këshillit të Evropës⁴⁴

Konventa e së Drejtës Penale për Korrupsion e Këshillit të Evropës (CoE) është krijuar për shkak të nevojës prioritare për ta zbatuar politikën e përbashkët penale të orientuar ndaj mbrojtjes së shoqërisë nga korrupsioni, përfshirë edhe miratimin e legjisllacionit përkatës dhe masave parandaluese. Konventa ka një shtrirje të gjerë dhe përfshin një numër të madh të aktiviteteve korruptuese karakteristike për sektorin publik dhe privat, por nuk e njeh dimensionin gjinor të korrupsionit. Fokusi i Konventës është inkriminimi i marrjes së mitës dhe dimensionit financiar, respektivisht dimensionit material të korrupsionit. Republika e Maqedonisë së Veriut e nënshkroi Konventën e së Drejtës Penale për korrupsion të CoE në vitin 1999, e cila ka hyrë në fuqi në vitin 2002.

⁴³ Konventa e OKB-së për luftë kundër korrupsionit, mund të merret në <https://customs.gov.mk/images/documents/borbaKorupcija/oonProtivKorupcija.pdf>

⁴⁴ Criminal Law Convention on Corruption, Strasbourg, 27.I.1999, available at <https://rm.coe.int/168007f3f5>



Konventa e së Drejtës Civile për Korrupsion e Këshillit të Evropës⁴⁵

Konventa e së Drejtës Civile për Korrupsion e Këshillit të Evropës, e potencon faktin se korrupsioni paraqet kërcënim të madh për sundimin e së drejtës, demokracisë dhe të drejtave të njeriut, drejtësisë dhe drejtësisë sociale. Qëllimi kryesor i kësaj Konvente është që shtetet anëtare në legjislacionin e tyre kombëtar të parashohin masa efektive juridike për personat që janë dëmtuar si rezultat i veprave të korrupsionit, për t'u mundësuar që t'i mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre, përfshirë edhe mundësinë e marrjes së kompensimit të dëmit. Kompensimi i dëmit, që është paraparë me këtë Konventë, mund të jetë edhe sipas humbjeve jomateriale. Megjithëse përkufizimi i korrupsionit në kuadër të kësaj Konvente është mjaft i gjerë dhe me të mund të përfshihet edhe zhvatja seksuale, e me këtë edhe personat që janë dëmtuar, respektivisht kanë qenë viktimat të zhvatjes seksuale, kanë mundësi që t'i mbrojnë të drejtat e tyre, megjithatë dimensionin gjinor, nuk është njohur në mënyrë eksplicite. Republika e Maqedonisë së Veriut, e nënshkroi këtë Konventë në vitin 2000, ndërsa ka hyrë në fuqi në vitin 2003.

Grupi i shteteve kundër korrupsionit – Këshilli i Evropës

Grupi i shteteve kundër korrupsionit (GREKO) është themeluar në vitin 1999 nga Këshilli i Evropës. Qëllimi i GREKO-s është përmirësimi i kapacitetit të anëtarëve për luftë kundër korrupsionit, përmes përcjelljes së harmonizimit të tyre me standardet antikorruptuese të Këshillit të Evropës, përmes procesit dinamik të vlerësimit të ndërsjellë dhe peer pressure. Në këtë mënyrë identifikohen mungesat e politikave kombëtare antikorruptuese, duke nxitur reformat e nevojshme ligjore, institucionale dhe praktike. GREKO gjithashtu siguron platformë për ndarjen e praktikave më të mira të parandalimit dhe zbulimit të korrupsionit. Republika e Maqedonisë së Veriut është anëtare e GREKO-s që nga viti 2000.

GREKO në vitin 2012 organizoi diskutime të shumta për nevojën e përfshirjes së perspektivës gjinore gjatë luftës kundër korrupsionit.

⁴⁵ Civil Law Convention on Corruption, Strasbourg, 4.XI.1999, available at <https://rm.coe.int/168007f3f6>

Raporti i harmonizimit – rrethi i pestë i vlerësimit⁴⁶

Në rrethin e pestë të vlerësimit të GREKO-s janë dhënë 23 rekomandime në aspekt të “Parandalimit të korrupsionit dhe promovimit të integritetit të pushtetit qendror (personat të cilëve u janë besuar funksione më të larta ekzekutive - LINF) dhe organet e zbatimit të ligjit (OSC).” Në këtë Raport shteti ynë nuk merr rekomandime specifike gjinore megjithëse nga vitin 2012 GREKO fillon me shqyrtimin e dimensionit gjinor të korrupsionit. Risitë më të rëndësishme që janë vendosur si rezultat i rekomandimeve janë: emërimi i zëvendëskryetarit të Qeverisë, përgjegjës për luftën kundër korrupsionit dhe krimit, zhvillim të qëndrueshëm dhe resurse njerëzore dhe vendosje të “Kodit të etikës për anëtarët e Qeverisë dhe bartësve të funksioneve publike të emëruar nga Qeveria“.

Kodi i etikës për anëtarët e Qeverisë dhe bartësit e funksioneve publike të emëruar nga Qeveria nuk ka perspektivë gjinore dhe para se gjithash fokusohet në rregullimin e mënyrës së sjelljes dhe punës së kryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, ministrat, zëvendësministrat dhe bartësit e tjerë të funksioneve ekzekutive, të emëruar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Megjithatë zëvendëskryetari i Qeverisë, përgjegjës për luftë kundër korrupsionit dhe krimit, zhvillim të qëndrueshëm dhe resurse njerëzore, duke e njohur rëndësinë e dimensionit gjinor të korrupsionit në kuadër të këtij hulumtimi, theksoi se “në legjislacionin vendor antikorrupsues, nevojitet që të zhvillohet definicion dhe kornizë juridike për zhatjen seksuale, për të mundësuar ndjekje dhe përndjekje të rasteve. Këtu intervenimi është i nevojshëm para së gjithash në Kodin Penal.”⁴⁷

Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalim dhe Luftë Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në familje – Konventa e Stambollit

Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalim dhe Luftë Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, e njeh dhe potencon faktin që dhuna ndaj grave është manifestim i raporteve të pabarabarta historike të fuqisë ndërmjet grave dhe burrave, e njëherazi e njeh edhe natyrën strukturore të dhunës ndaj grave si dhunë me bazë gjinore, si dhe se dhuna ndaj grave është një prej mekanizmave kryesore shoqërore me të cilën gratë detyrohen në pozitë nënshtruese në raport me burrat. Qëllimi kryesor i Konventës së Stambollit është “mbrojtja e grave nga të gjitha format e dhunës dhe parandalimit, përndjekjes dhe eliminimit të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.”⁴⁸

⁴⁶ Raporti i harmonizimit – rrethi i pestë i vlerësimit GREKO, mund të merret në <https://www.pravda.gov.mk/Upload/Documents/Izvestaj%20GREKO%205%20krug.pdf>

⁴⁷ Ljupčo Nikollovski, Zëvendëskryetar i Qeverisë për Luftë Kundër Korrupsionit dhe Krimit, Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Resurse Njerëzore (Intervistë 08.10.2021)

⁴⁸ Neni 1-Qëllimet e Konventës, Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje-Konventa e Stambollit, mund të merret në <https://rm.coe.int/168046253a>



Të gjitha vendet që e kanë ratifikuar Konventën e Stambollit, përfshirë edhe Republikën e Maqedonisë së Veriut (që ka hyrë në fuqi më 1 korrik 2018), obligohen që të sigurojnë se funksionarët, nëpunësit, institucionet dhe aktorët tjerë që veprojnë në emër të shtetit përmbahen nga pjesëmarrja në çfarëdo akti të dhunës ndaj grave. Megjithëse nuk është definuar në mënyrë eksplicite nëse e shohim zvatjen seksuale si formë e dhunës seksuale ndaj grave, bazuar në raportet e pabarabarta të fuqisë ndërmjet burrave dhe grave, së këndejmë del edhe obligimi që e njëjta të rregullohet me legjislacionin kombëtar.

Gjatë përkufizimit të dhunës seksuale, Konventa e Stambollit thekson se “pëlqimi patjetër duhet të jepet vullnetarisht si rezultat i vullnetit të lirë të personit, të vlerësuar në kontekst të rrethanave.”⁴⁹ Gjatë ekzistimit të zvatjes seksuale si formë e dhunës seksuale, pëlqimi është rezultat i detyrimit psikologjik. Zakonisht personave të cilëve u bëhet zvatje seksuale janë persona të rrezikuar, ndërsa kryerësit janë gjithmonë në pozitë të fuqisë. Së këndejmë rekomandimi i Konventës së Stambollit e cila ka të bëjë me rrethanat rënduese gjatë kryerjes së veprave penale kundër grave kërkon që si rrethana rënduese të legjislacionit kombëtar të konsiderohen:

- vepra penale është kryer nga personi që e ka keqpërdorur autoritetin e tij;
- vepra penale është kryer ndaj personit që ka qenë i cenueshëm për shkak të rrethanave të caktuara.

Duke analizuar dispozitat e Konventës së Stambollit mund të konkludojmë se Republika e Maqedonisë së Veriut ka për obligim që ta inkriminojë zvatjen seksuale si një prej formave të dhunës seksuale ndaj grave, por jo edhe si veprim korruptiv që është në kundërshtim me rekomandimet e Asociacionit Ndërkombëtar të Gjykatëseve.

Është e rëndësishme që të merret parasysh përdorimi i ndryshëm i nocionit të zvatjes seksuale, respektivisht sekstorcionit në kuadër të grupit të punës së GREVIO, të mbajtur më 23 tetor 2020. Qëllimi i këtij grupi të punës ishte hulumtimi i rëndësisë së vëllimit të zbatimit të Konventës së Stambollit lidhur me dhunën ndaj grave përmes internetit dhe teknologjisë dhe të mbikëqyret zhvillimi i rekomandimit të përgjithshëm. Në kuadër të rekomandimit të përgjithshëm të përpunuar nga grupi i punës së GREVIO, nocioni i sekstorcionit shfrytëzohet për të përshkruar vepër të ndryshme nga ajo që është lëndë e analizës, respektivisht:

⁴⁹ Ibid.

“Zhvatja seksuale, gjithashtu e quajtur si “sektorcion” është akt i shfrytëzimit të kërcënimit nga publikimi i përmbajtjes seksuale (fotografi, video, mashtrime, portale seksuale) për të kërcënuar, detyruar ose kushtëzuar dikë, ose për më shumë përmbajtje ose për para, e ndonjëherë edhe për të dyja.”⁵⁰

Analiza krahasuese ligjore

Për qëllime të analizës krahasuese të kornizës ndërkombëtare juridike janë analizuar Kodet Penale dhe Ligjet për parandalimin e korrupsionit të dy shteteve të Ballkanit Perëndimor: Mali i Zi dhe Bosnja dhe Hercegovina, dy shtete anëtare të Bashkimit Evropian – Sllovenia dhe Finlanda, dy shtete anëtare të OSBE-së Zvicra dhe Kirgistani dhe dy prej Shteteve të Bashkuara të Amerikës – Kalifornia dhe Arkanzasi. Qëllimi i analizës ishte që të gjenden praktika të mira ligjvënëse që mund të zbatohen për inkrimimin e sekstrocionit, respektivisht zhvatjes seksuale si formë e korrupsionit në Maqedoninë e Veriut.

Shtetet e Ballkanit Perëndimor

Në rajonin e Ballkanit Perëndimor, përfshirë edhe Republikën e Maqedonisë së Veriut, më së shpeshti gjatë inkriminimit të veprës së zhvatjes seksuale në kodet penale është lënë jashtë elementi korruptues dhe i njëjti pjesërisht rregullohet në kuadër të veprave penale kundër lirisë gjinore dhe moralit, respektivisht kundër integritetit gjinor. I tillë është rasti edhe në Kodet Penale të Republikës së Malit të Zi, Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Republikës Srpska.

Mali i Zi

Mali i Zi në Kodin Penal me nenin 207 e rregullon pjesërisht zhvatjen seksuale në mënyrën në vijim: “Abuzim seksual me keqpërdorim të pozitës”

“(1) I cili duke keqpërdorur pozitën e tij do të detyrojë në abuzim seksual ose akt të ngjashëm person i cili në raport me të gjendet në pozitë të nënshtruar ose varur, do të dënohet me burg nga tre muaj deri në tre vite.”⁵¹

⁵⁰ Gender Equality Commission (GEC) Draft Comments of the Gender Equality Commission on GREVIO’s draft General Recommendation on the digital dimension of violence against women, available at <https://rm.coe.int/gec-2021-4-rev-gec-comments-on-grevio-gen-rec-digital-dimension-vaw-29/1680a20817>

⁵¹ Neni 207, Kodi Penal i Republikës së Malit të Zi, që mund të merret në <https://www.paragraf.me/propisi-crnegore/krivicni-zakonik-crne-gore.html>



Mali i zi si një rrethanë rënduese gjatë inkriminimit të abuzimit seksual duke keqpërdorur pozitën e merr pasojën “shtatzëni e shkaktuar” dhe parasheh dënim me burg nga 6 muaj deri në 5 vite.

Megjithëse gjatë përkufizimit të veprës si “abuzim seksual duke keqpërdorur pozitën” janë përfshirë edhe komponenti seksual dhe korruptues, prapë se prapë mënyra e kryerjes së veprës dhe dëshmimi i saj mund të jetë pengesë për të arritur drejtësinë. Kur bëhet fjalë për abuzim sipas përkufizimit mendohet për aktet e dhunshme seksuale, respektivisht nevojitet që të shfrytëzohet forca/detyrimi fizik. Zhatja seksuale si akt në shumicën e rasteve nuk përmban forcë por detyrim psikik.

Në Ligjin për parandalimin e korrupsionit në Mal të Zi, korrupsioni definohet si “çdo keqpërdorim i pozitës zyrtare, së punës, respektivisht shoqërore ose ndikimi me qëllim të fitimit të dobisë personale ose dobisë për dikë tjetër”⁵². Si rrjedhojë, megjithëse në këtë ligj nuk definohet në mënyrë eksplicite zhatja seksuale si vepër e korrupsionit, vetë vepra “abuzim seksual me keqpërdorimit të pozitës” megjithëse është pjesë e veprave penale kundër lirisë gjinore lë hapësirë që të interpretohet edhe si vepër e korrupsionit për shkak të përmbajtjes së veprës “keqpërdorim i pozitës”.

Bosnja dhe Hercegovina

Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës

Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës në Kodin Penal, në Kreun nëntëmbëdhjetë – Vepra penale kundër lirisë gjinore dhe moralit, me nenin 205 rregullon:

„Marrëdhënien seksuale me keqpërdorim të pozitës“

“(1) I cili duke keqpërdorur pozitën do të detyrojë për marrëdhënie gjinore ose aktivitet tjetër të ngjashëm person tjetër me qëllim të përfitimit pronësor, familjar, shoqëror, shëndetësor ose pozitë tjetër ose i cili gjendet në gjendje të rëndë dhe të varur ndaj tij, do të dënohet me burg nga tre muaj deri në tre vite”⁵³

Federata e Bosnje e Hercegovinës në Kodin e vet Penal ka përkufizim më specifik dhe më të afërt të përkufizimit të veprës me nocionin “marrëdhënie gjinore me keqpërdorim të pozitës” deri te ajo që paraqet zhatje seksuale si formë e korrupsionit. Shfrytëzimi i nocionit “marrëdhënie gjinore” në vend të “abuzimit” jep udhëzime për interpretimin

⁵² Ligji për parandalimin e korrupsionit në Republikën e Malit të Zi, që mund të merret në gjuhën malazeze në: https://www.antikorupcija.me/media/documents/Zakon_o_sprje%C4%8Davanju_korupcije.pdf

⁵³ Article 205, Criminal code of the Federation of Bosnia and Herzegovina, available at https://www.legislationline.org/download/id/8500/file/CC_FBiH_am2017_eng.pdf

e veprës, pavarësisht faktit nëse ka pasur përdorim të forcës fizike për detyrim/zhvatje, që është karakteristike për zhvatjen seksuale si formë e korrupsionit. Pozita pronësore, familjare, shoqërore, shëndetësore, si dhe pozitat tjera ose gjendja e vështirë janë pikërisht faktorët të cilët duhet të merren parasysh gjatë vlerësimit të gjendjes së personit të zhvatur, kundrejt personit me pozitë dhe fuqi.

Sipas ligjit të Agjencisë për parandalimin e korrupsionit dhe koordinim të luftës kundër korrupsionit në Bosnje e Hercegovinë, korrupsioni nënkupton “çfarëdo qoftë keqpërdorimi të fuqisë së besuar të nëpunësit shtetëror ose personit me pozitë politike në nivel shtetëror, entitet, qark, në nivel të qarkut Bërçko të Bosnjës dhe Hercegovinës, në nivel të qytetit ose komunës, që mund të sjellë dobi private.”⁵⁴ Në legjislacionin e Bosnjës dhe Hercegovinës shfrytëzohen dy nocione të ndryshme “keqpërdorimi i pozitës” dhe “keqpërdorimi i fuqisë” që në esencë shënojnë veprim të njëjtë ose të ngjashëm sepse gjatë përkufizimit të korrupsionit fuqia del nga pozita e personit, andaj me keqpërdorimin e fuqisë keqpërdoret edhe pozita dhe anasjelltas.

Republika Srpska

Republika Srpska në Kodin Penal, në Kreun katërmbëdhjetë e cila i përkufizon veprat penale kundër integritetit gjinor me nenin 168, në mënyrë të ngjashme si Mali i Zi, e rregullon pjesërisht zhvatjen seksuale në veprë:

„Abuzim seksual me keqpërdorim të pozitës“

„I cili duke keqpërdorur pozitën e vet do të detyrojë në akte seksuale ose aktivitet të ngjashëm seksual person i cili në raport me të gjendet në pozitë të nënshtuar ose varur, do të dënohet me burg nga dy deri në pesë vite“⁵⁵

Republika Srpska megjithëse në mënyrë të ngjashme e inkriminon veprën sikur Mali i Zi, dallohet nga Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Malit të Zi për nga lartësia e dënimit për veprën, respektivisht për dallim nga dy shtetet tjera ku dënimi minimal është 3 muaj, ndërsa ai maksimal është 3 vite, në Republikën Srpska dënimi minimal është 2 vite, kurse ai maksimal është 5 vite. Ligji për çrënjosjen e korrupsionit, krimin të organizuar dhe formave më të rënda të krimin ekonomik nuk e rregullon zhvatjen seksuale dhe nuk përmban përkufizime të veprës së korrupsionit.⁵⁶

⁵⁴ Ligji i agjencisë për parandalimin e korrupsionit dhe koordinimit në luftën kundër korrupsionit (zbatohet në nivel të Federatës së Bosnje e Hercegovinës dhe distriktit Brçko), që mund të merret në gjuhën boshnjake në: http://msb.gov.ba/PDF/35_Zakon%20o%20%20agenciji%20za%20prevenciju%20korupciji%20%20103-09.pdf

⁵⁵ Article 168, Criminal Code of The Republika Srpska of Bosnia and Herzegovina, available at <https://www.legislationline.org/documents/action/popup/id/23380/preview>

⁵⁶ Ligji për eliminimin e korrupsionit, format e organizuara dhe më të rënda të krimin ekonomik, që mund të merret në gjuhën serbe: <https://www.narodnaskupstinar.net/?q=la/akti/usvojeni-zakoni>



Shtetet anëtare të Bashkimit Evropian

Shtetet anëtare të Bashkimit Evropian Kodet Penale të të cilave u analizuan për nevojat e këtij hulumtimi janë Sllovenia dhe Finlanda.

Sllovenia

Në Kodin Penal të saj, në kreun e nëntëmbëdhjetë që i rregullon veprat penale kundër integritetit gjinor, Republika e Sllovenisë e inkriminon veprën:

„Shkelja e integritetit gjinor duke keqpërdorur pozitën“

”Ai i cili duke keqpërdorur pozitën e tij detyron një person të gjinisë së njëjtë ose të ndryshme i cili është në pozitë vartëse ose varet nga ai, që të ketë marrëdhënie seksuale me të ose t’i nënshtrohet çfarëdo akti tjetër seksual, duhet të dënohet me burg prej pesë vitesh.”⁵⁷

Republika e Sllovenisë e rregullon zvatjen seksuale si vepër penale kundër integritetit seksual ku në masë të konsiderueshme inkorporohet edhe komponenti korruptues, duke i specifikuar dhe inkriminuar në mënyrë shtesë marrëdhëniet e detyrueshme gjinore ndërmjet personave të gjinisë së njëjtë. Vepra penale i përmban të tre kushtet kryesore për ekzistimin e zvatjes seksuale si një veprim korruptues: keqpërdorimi i pozitës, marrëdhënia seksuale ose veprim dhe detyrim tjetër seksual. Gjithashtu, në kreun e njëzetegjashtë, i cili i rregullon veprat penale kundër detyrës zyrtare, organeve dhe fondeve publike, Republika e Sllovenisë i inkriminon veprat: keqpërdorimi i pozitës dhe autorizimeve zyrtare, marrja e mitës – përfshirë edhe atë jomaterialen, respektivisht përfitimet tjera dhe pranimin e tyre për ndërmjetësim të paligjshëm.

Me këtë mund të konkludojmë se Republika e Sllovenisë ka përpiluar një rregullim gjithëpërfshirës juridik të veprës së zvatjes seksuale si një veprim korruptues.

⁵⁷ Article 174, Criminal code of Republic of Slovenia, available at https://www.legislationline.org/download/id/9232/file/SLOV_CC.pdf

Finlanda

Zhvatja seksuale në Finlandë megjithëse nuk është e rregulluar në mënyrë eksplicite, mund të konsiderohet si një prej formave të keqpërdorimit seksual (563/1998) e inkriminuar në pjesën 5 të Kodit Penal.

Me keqpërdorim seksual nënkuptohet “personi i cili e keqpërdor pozitën e tij dhe detyron njërin prej tyre në marrëdhënie seksuale, akt tjetër seksual që në esencë e shkel të drejtën e tij të vetëpërcaktimit seksual ose durimit të një vepre të tillë.”⁵⁸

Në paragrafin katër si viktimë e kësaj vepre mund të paraqitet “personi i cili në veçanti varet nga kryerësi, kur kryerësi e shfrytëzon këtë varësi, do të dënohet për keqpërdorim seksual me dënim në para ose burg prej më së shumti katër vitesh”

Me këtë vepër përfshihen elementet e keqpërdorimit të pozitës nga ana e kryerësit dhe varësia nga kryerësi, marrëdhënia seksuale ose akti seksual si dhe joshja. Nuk janë të potencuar qartë elementi korruptues dhe detyrimi psikologjik, andaj me këtë edhe nuk mund ta vlerësojmë zhvatjen seksuale si një veprim korruptues tërësisht të inkriminuar. Finlanda gjithashtu me inkriminimin e kundërvajtjeve të kryera gjatë shërbimit, rregullon edhe marrjen mitës, përfshirë edhe atë jomaterialen, respektivisht, përfitimet tjera, mit marrjen me rrethana të rënduara në këmbim për të kryer ose moskryer shërbim, si dhe keqpërdorim të funksionit publik.

Shtetet anëtare të OSBE-së

Shtetet anëtare të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim të Evropës, Kodet Penale të të cilëve ishin lëndë e analizës gjatë këtij hulumtimi janë Zvicra dhe Kirgistani.

Zvicra

Në Kodin Penal të Zvicrës në kreun e pestë që i rregullon kundërvajtjet kundër integritetit seksual, komponentët e ndryshëm të zhvatjes seksuale inkriminohen përmes dy neneve në pjesën e kundërvajtjeve kundër lirisë seksuale dhe nderit.

⁵⁸ 563/1998 Criminal Code of Finland, available at https://www.legislationline.org/download/id/6375/file/Finland_CC_1889_am2015_en.pdf



„Sulm i pahijshëm“

„Çdo person që përdor kërcënime, forcë ose presion psikologjik kundër një personi tjetër ose e bën atë person të paaftë për ta kundërshtuar, me qëllim për ta detyruar që të tolerojë akt seksual të ngjashëm me marrëdhënien seksuale ose çfarëdo akti tjetër seksual, ndëshkohet me dënim me burg jo më shumë se dhjetë vite ose dënim me para.“⁵⁹

„Eksplotimi i personit në pozitë të nevojës ose varësisë“

„Çdo person i cili do të nxisë ose do të joshë dikë tjetër në akt seksual duke shfrytëzuar pozitën e nevojës ose lidhjes së varësisë të bazuar në punësim ose lidhje tjetër varësie, ndëshkohet me dënim me burg jo më shumë se tre vite ose dënim me para.“⁶⁰

Kodi penal i Zvicrës është një prej instrumenteve të rralla që e njeh, rregullon dhe inkriminon presionin psikologjik gjatë detyrimit në akt ose marrëdhënie seksuale me veprën sulm i pahijshëm. Zvatja seksuale bazohet pikërisht në presionin psikologjik që vjen nga një person në pozitë të fuqisë. Zvicra gjithashtu e sanksionon penalisht edhe personin i cili duke e shfrytëzuar pozitën e nevojës së dikujt ose gjatë lidhjes së bazuar në punësim, respektivisht i punësuar epror do të zvatë akt seksual. Me rregullimin e tillë ligji i përfshin të gjithë punonjësit, respektivisht edhe ata të sektorit publik dhe atij privat. Gjithashtu në kundërvajtjet kundër detyrës zyrtare ose profesionale është inkriminuar edhe keqpërdorimi i funksionit publik.

Në këto dy vepra penale janë inkriminuar edhe tri kushtet për ekzistimin e zvatjes seksuale, siç janë veprimet korruptuese: keqpërdorimi i pozitës, aktiviteti seksual dhe detyrimi psikologjik, me këtë Zvicra ofron një përgjigje dhe mbrojtje juridike gjithëpërfshirëse nga zvatja seksuale.

Kirgistani

Në Kodin Penal të Kirgistanit, në veprat penale kundër integritetit seksual dhe lirisë seksuale, pjesërisht rregullohet edhe zvatja seksuale me nenin 163.

„Detyrimi i veprimeve të natyrës seksuale“

„Detyrimi i një personi për të pasur marrëdhënie seksuale, sodomi, veprime lezbike ose të kryejë akte tjera të natyrës seksuale përmes detyrimit ose shfrytëzimit të varësisë materiale ose varësive tjera të viktimës...“⁶¹

⁵⁹ Article 189, Swiss Criminal Code, available at https://www.legislationline.org/download/id/8991/file/SWITZ_Criminal%20Code_as%20of%202020-07-01.pdf

⁶⁰ Article 193, Swiss Criminal Code

⁶¹ Neni 163, Kodi Penal i Kirgistanit, mund të merret në gjuhën ruse <http://cbd.minjust.gov.kg/act/view/ru-ru/111527>

Ajo që është karakteristike për Kodin Penal të Kirgistanit është se gjatë kryerjes së kësaj veprë, krahas dënimit me para ose me burg, sanksionohet edhe duke iu marrë e drejta për të kryer pozita të caktuara si rezultat i keqpërdorimit të fuqisë. Edhe krahas mungesës për theksim eksplícit të elementit korruptues, prapë se prapë i njëjti sanksionohet. Mund të konkludojmë se zvatja seksuale si veprim korruptues është pjesërisht e rregulluar në Kirgistan.

Shtete nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Shtete e SHBA-së, kodet penale të të cilëve u analizuan për nevojat e hulumtimit janë Kalifornia dhe Arkanzasi. Nocioni sekstorcion në shtetet e SHBA-se shfrytëzohet për një veprë tjetër penale, respektivisht i përshkruan krimet që ndodhin në internet kur një i rritur do të bind një person nën moshën 18 vjeçare për të shpërndarë fotografi me përmbajtje seksuale ose për të kryer akte seksuale në ueb kamerë⁶². Zvatja seksuale si veprë korruptuese nuk është e definuar në SHBA.

Kalifornia

Në Kodin Penal të Kalifornisë, zvatja seksuale rregullohet në veprat penale kundër personalitetit që përfshijnë sulm seksual dhe vepra penale kundër dinjitetit dhe moralit publik. Zvatja seksuale rregullohet me veprën e përdhunimit⁶³ që definohet si akt i marrëdhënies seksuale të kryer me person që nuk është në lidhje martesore me kryerësin, e që është bërë në rrethana të ndryshme.

Paragrafi 7 si përdhunim vlerëson “aty ku akti është kryer kundër vullnetit të viktimës përmes kërcënimit se do të shfrytëzohet autorizimi i nëpunësit publik për të burgosur, arrestuar ose depërtuar viktimën ose dikë tjetër, ndërsa viktimja ka besim racional se kryerësi është nëpunës publik. Siç shfrytëzohet në këtë paragraf, “nëpunës publik” është personi i punësuar në një agjenci qeveritare që ka autorizime, si pjesë e asaj pozite, për të burgosur, arrestuar ose deportuar dikë tjetër. Dhunuesi në fakt nuk është patjetër të jetë nëpunës publik”⁶⁴.

⁶² FBI Launches Sextortion Awareness Campaign in Schools, 2019, available at: <https://www.fbi.gov/news/stories/stop-sex-tortion-youth-face-risk-online-090319>

⁶³ Her lawyer, Sexual Coercion in California: What You Need to Know, available at <https://herlawyer.com/sexual-coercion-california/>

⁶⁴ Article 261, California Penal Code, available at https://leginfo.ca.gov/faces/codes_displayText.xhtml?lawCode=PEN&division=&title=9.&part=1.&chapter=1.&article



Me këtë paragraf, zvatja seksuale është e rregulluar vetëm kur bëhet fjalë për persona jashtëzakonisht të cenueshëm, si të burgosur, imigrantë, punëtorë seksualë etj. Por me paragrafin (b) qartësohet shfrytëzimi i nocionit detyrim në kuadër të Ligjit dhe se çfarë merret parasysh gjatë vlerësimit të veprës.

„detyrim do të thotë kërcënim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me forcë që nënkupton dhunë, rrezik ose hakmarrje të mjaftueshme për të detyruar person racional në pozitë vartëse të kryej veprë që në rrethana tjera nuk do ta kryente, ose të pajtohet me një akt që në rrethana tjera nuk do të nënshtrohej. Rrethanat e përgjithshme, përfshirë edhe moshën e viktimës dhe raportin me të akuzuarin, që duhet të merren parasysh gjatë vlerësimit të ekzistimit të detyrimit.“⁶⁵

Specifike për inkriminimin e tillë është fakti se zvatja seksuale vlerësohet si formë e përdhunimit, Në këtë mënyrë rregullohet zvatja seksuale në shtetin e Kalifornisë, por jo si veprim korruptues, por si formë e dhunës seksuale. Megjithëse detyrimi psikik merret parasysh gjatë vlerësimit të veprës, prapë se prapë korniza ligjore nuk është gjithëpërfshirëse.

Arkanzasi

Ajo që është shumë specifike për shtetet e SHBA-së është gërshetimi i veprave penale që përfshihen me nocionin e sekstorcionit, respektivisht zvatjes seksuale. Kështu me Kodin Penal të Arkanzasit si veprë nga kundërvajtjet seksuale në nenin 5-14-113 konsiderohet se kemi zvatje seksuale në këto raste:

„(1) Me qëllim për të detyruar person tjetër në kontakt seksual ose sjellje eksplicite seksuale, personi njofton kërcënim për:

(A) dëmtim të pronës ose cenim të dinjitetit të personit tjetër; ose

(B) Përpunon ose distribuon incizim të një personi tjetër të angazhuar në sjellje eksplicite seksuale ose i paraqitur në gjendje lakuriqësie;“⁶⁶

Me këtë mënyrë të inkriminimit të zvatjes seksuale në tërësi lihet anash komponenti korruptues, respektivisht keqpërdorimi i fuqisë, ndërsa detyrimi bazohet në përdorimin e forcës fizike dhe kërcënimin real për cenimin e autoritetit të personit tjetër. Gjatë përpunimit të kornizës juridike për rregullimin e sekstorcionit në një shtet, është shumë e rëndësishme që të përzgjidhet nocioni përkatës të cilin popullsia lokale, por edhe faktorët juridikë relevantë do ta njohin dhe identifikojnë veprën penale përkatëse.

⁶⁵ Article 261 (b), California Penal Code *ibid*.

⁶⁶ 5-14-113, Arkansas Penal Code, available at <https://law.justia.com/codes/arkansas/2017/title-5/subtitle-2/chapter-14/subchapter-1/section-5-14-113/>

Republika e Maqedonisë së Veriut për momentin ka qasje me të ngjashme në inkriminimin e pjesshëm të veprës me Malin e Zi dhe Republikën Srpska. Nga analizimi i Kodeve Penale të lartpërmendura si korniza më adekuate juridike për rregullimin gjithëpërfshirës të zhatjes seksuale si veprim korruptues, mund t'i veçojmë ligjet e Zvicrës dhe Sllovenisë. Është e rëndësishme që të theksohet edhe qasja e Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës e cila është e vetmja që në mënyrë eksplicite i thekson faktorët që kanë rëndësi të madhe gjatë vlerësimit të pozitës së varësisë së viktimës në raport me kryerësin.



Konstatimet kryesore nga intervistat dhe grupet e fokusit

Për qëllimet e hulumtimit janë realizuar 16 intervista dhe tri grupe të fokusit me faktorët dhe ekspertët relevantë nga sfera e korrupsionit në mesin e të cilëve edhe gjykatës, prokurorë publikë, avokatë, deputete, përfaqësues të Komisionit për Parandalimin e Korrupsionit, përfaqësues të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, akademikë dhe përfaqësues të sektorit civil.

Konstatimet kryesore që u nxorën nga intervistat janë si vijon:

Njohja e formave gjinore të korrupsionit

- Nocioni sekstorcion është i njohur te një pjesë më e vogël e të intervistuarve, ndërsa nocioni i zhvatjes seksuale konsiderohet si më adekuat për shoqërinë tonë;
- Zhvatja seksuale njihet si formë e dhunës me bazë gjinore, por te një pjesë me e vogël e të intervistuarve edhe si veprim korruptues gjinor;
- Korrupsioni ka ndikim të ndryshëm ndaj burrave dhe grave meqë në pjesën më të madhe të pozitave të fuqisë në shtet gjenden burrat;

Përfaqësimi i zhvatjes seksuale në Republikën e Maqedonisë së Veriut

- Megjithëse ekzistojnë numër i mjaftueshëm i hulumtimeve, të intervistuarit besojnë se zhvatja seksuale në masë të madhe është përfaqësuar në jetën e përditshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- Sferat ku është më e përfaqësuar zhvatja seksuale si veprim korruptues sipas të intervistuarve janë: Administrata shtetërore (nivel qendror dhe lokal), arsimit i lartë dhe sektori privat/i biznesit;
- Konsiderohet se zhvatja seksuale si veprim korruptues është më e përfaqësuar aty ku ka sistem të karrierës dhe ku ka një të drejtë diskreditive për vendimmarrje;
- Të intervistuarit konsiderojnë se zhvatja seksuale më së shpeshti shfrytëzohet për punësim si një problem më i theksuar në shtet. Gjithashtu shfrytëzohet edhe për të ruajtur vendin e punës, avancim, vlerësim në arsimin e lartë dhe realizim të të drejtave të caktuara që u takojnë me ligj;

- ✎ Gratë e reja në bazë të standardeve të bukurisë në shoqëri, veçohen si më të cenueshme ndaj zhatjes seksuale, veçanërisht ato më të rrezikuara: të papunësuar, nëna të vetme, të varfër etj.
- ✎ Pjesa më e madhe të intervistuarve kanë dëgjuar për raste konkrete të zhatjes seksuale nga të afërmit e tyre, bashkëpunëtorët, miqtë dhe/ose përmes mediave;
- ✎ Pjesa më e madhe e rasteve të zhatjes seksuale për të cilat kanë dëgjuar, janë në arsimin e lartë dhe sektorin privat/e biznesit;

Denoncimi dhe sanksionimi i zhatjes seksuale

- ✎ Konsiderohet se zhatja seksuale denoncohet shumë pak për shkak të turpit nga gjykimet dhe frika për humbjen e vendit të punës;
- ✎ Sanksionet për zhatjen seksuale duhet t'i bart vetëm zhatësi që është në pozitë të fuqisë dhe e keqpërdor atë, nëse dënohet edhe viktima atëherë vepra nuk denoncohet;
- ✎ Ofrimi i shërbimit seksual në këmbim të dobisë, gjithashtu konsiderohet si formë e korrupsionit, por përgjegjësia duhet të kërkohej te bartësi i fuqisë.

Rregullativa ligjore

- ✎ Sipas ekspertëve të intervistuar dhe faktorëve relevantë, Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktin e interesave ka një përkufizim mjaft të gjerë që e përfshin pjesën më të madhe të veprimeve korruptuese, përfshirë edhe korrupsionin aktiv dhe pasiv dhe është në pajtim me Konventat për luftë kundër korrupsionit, që janë ratifikuar nga Republika e Maqedonisë së Veriut;
- ✎ Është potencuar nevoja për vlerësimin e implementimit të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave;
- ✎ Pjesa më e madhe e të intervistuarve konsiderojnë se Kodi Penal nuk i rregullon mjaftueshëm dhe/ose në mënyrë adekuate format e ndryshme të korrupsionit;
- ✎ Zhatja seksuale konsiderohet se nuk është rregulluar në mënyrë adekuate me legjislacionin kombëtar, por megjithatë për të mund të veprohet edhe në bazë të veprave të ndryshme në ligjet ekzistuese;
- ✎ Të gjithë të intervistuarit konsiderojnë se zhatja seksuale duhet të rregullohet me Kodin Penal;



Përgjigja institucionale

- Si problem i madh u theksua edhe zbatimi joadekuat i ligjeve ekzistuese dhe mospasja e një përgjigjeje adekuate sistematike;
- Pas inkriminimit të veprës është potencuar nevoja për trajnimin e gjykatësve, prokurorëve publikë, avokatëve dhe faktorëve tjerë relevantë për zbatimin e tij adekuat;

Konstatimet kryesore që u nxorën nga grupi i fokusit me përfaqësuesit e vetëqeverisjes lokale janë në vijim:

Njohja e formave gjinore të korrupsionit

- Format gjinore të korrupsionit nuk janë mjaftë të njohura, por konsiderojnë se korrupsioni ndikon ndryshe ndaj burrave dhe grave për shkak të mungesës së balancës në shpërndarjen e fuqisë në shoqëri;
- Nocioni i sekstorcion është plotësisht i panjohur për përfaqësuesit e vetëqeverisjes lokale ndërsa zhatja seksuale njihet si një fenomen shoqëror;

Përfaqësimi i zhatjes seksuale në Republikën e Maqedonisë së Veriut

- Sferat në të cilat konsiderohet se është më e pranishme zhatja seksuale janë: sektori i biznesit privat, arsimit të lartë dhe administrata shtetërore në nivel qendror;
- Të anketuarit konsiderojnë se zhatja seksuale si veprim korruptues më së shumti shfrytëzohet për punësim, ruajtjen e vendit të punës, avancim, vlerësim në arsimin e lartë;
- Secili nga të anketuarit ka dëgjuar për rastet konkrete të zhatjes seksuale nga të afërmit e tij, miqtë, bashkëpunëtorët, ndërsa më karakteristike ishte shfrytëzimi i zhatjes seksuale për formimin e Listave të këshilltarëve në zgjedhjet e ardhshme, si dhe për ta kaluar provimin e vozitjes;
- Të intervistuarit konsiderojnë se vajzat/gratë e reja janë viktimat më të shpeshta të zhatjes seksuale;

Denoncimi dhe sanksionimi i zhatjes seksuale

- ✎ Të intervistuarit konsiderojnë se zhatja seksuale është shumë e pranishme në shoqërinë tonë, por nuk denoncohet mjaftueshëm. Si shkaqe kryesore për mosdenoncim janë theksuar: frika nga gjykimi, turpi nga akuzimi i viktimës se faktikisht ajo e ka ofruar shërbimin seksual në këmbim me një kundër-shërbim, por edhe mosbesimi i madh në institucionet;
- ✎ Pjesa më e madhe e përfaqësuesve të vetëqeverisjes lokale konsiderojnë se edhe zhatësi edhe i zhaturi nëse e pranon zhatjen janë përgjegjës për zhatjen seksuale;

Rregullativa ligjore

- ✎ Përfaqësuesit e njësisë së vetëqeverisjes lokale janë të njohur me Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave vetëm në domenin e punës së tyre
- ✎ Nuk janë të njoftuar mjaft nëse zhatja seksuale si veprim korruptues është e rregulluar me legjisllacionin kombëtar;
- ✎ Të anketuarit konsiderojnë se zhatja seksuale duhet të rregullohet me Kodin Penal;

Përgjigjja institucionale

- ✎ Në secilën komunë duhet të ekzistojë një person i emëruar për denoncim të brendshëm të veprimeve korruptuese, por rrallë marrin denoncime dhe të punësuarit në komunë nuk e dinë funksionin e tyre;
- ✎ U theksua nevoja për trajnime në nivel lokal për të njohur dhe denoncuar zhatjen seksuale.



Konstatimet kryesore që u nxorën nga grupi i fokusit me përfaqësuesit e sektorit civil janë si vijon:

Njohja e formave gjinore të korrupsionit

- Zhvatja seksuale është një nocion i njohur dhe njihet si formë e korrupsionit gjinor;
- Formë tjetër e korrupsionit gjinor që ishte theksuar krahas zhvatjes seksuale është edhe rasti për shkëmbimin e pllenimit invitro për vota në zgjedhje para rreth dhjetë viteve në Veles;
- Përfaqësuesit e sektorit joqeveritar konsiderojnë se korrupsioni ndikon shumë ndryshe te burrat dhe gratë në shoqërinë tonë. Si faktorë janë theksuar: varfëria femërore dhe shkalla më e lartë e papunësisë, rolet dhe normat gjinore, përfaqësimi më i madh i burrave në pozitat e fuqisë, respektivisht shpërndarja jo e barabartë e fuqisë, përfshirja më e madhe e grave në plotësimin e obligimeve administrative, etj;
- Zhvatja seksuale njihet si formë e dhunës me bazë gjinore, e ngjashme me shqetësimin seksual;

Përfaqësimi i zhvatjes seksuale në Republikën e Maqedonisë së Veriut

- Për shkak të mungesës së hulumtimit në këtë temë, përfaqësuesit e organizatave civile nuk ishin të sigurt se sa është e përfaqësuar zhvatja seksuale në Republika e Maqedonisë së Veriut, por në bazë të shembujve personale, rasteve nga ditët e të fakultetit dhe rasteve të lexuara në fushatën #TaniTregoj konsiderojnë se është e pranishme në jetën e përditshme;
- Sferat në të cilat konsiderojnë se zhvatja seksuale është me e pranishme janë: policia, administrata shtetërore në nivel lokal dhe qendror, por edhe në arsimin e lartë dhe shëndetësi;
- Të anketuarit konsiderojnë se zhvatja seksuale para se gjithash shfrytëzohet për avancim dhe punësim në shoqërinë tonë;
- Më se shpeshti gratë që janë viktima të korrupsionit, shërbimi që ju ofrohet në këmbim me marrëdhënien seksuale është diçka që gjithsesi u takon sipas ligjit;
- Nëpunësit policorë dhe personat që paraqiten rrejtshëm si nëpunës policorë, u potencuan si zhvatës të shërbimeve seksuale në 5-10 vitet e fundit, veçanërisht ndaj punëtorëve seksualë që punojnë në vende të hapura;

Denoncimi dhe sanksionimi i zhatjes seksuale

- ✎ Organizatave joqeveritare u janë drejtuar gra duke kërkuar këshilla për rastet e zhatjes seksuale. Njëra prej grave që ka refuzuar zhatje seksuale e punësuar në shëndetësi, ishte larguar nga puna për shkak të “kryerjes së pandërgjegjshme të detyrave të punës” e cila kishte ngritur procedurë procedurë, por nuk e kishte vazhduar atë;
- ✎ Sanksionimi duhet të jetë jo vetëm ndaj zhatësit që është në pozitë të fuqisë;

Rregullativa ligjore


- ✎ Pjesa më e madhe e të anketuarve nga sektori civil nuk janë mjaft të njoftuar për Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave dhe me atë nëse janë të rregulluara në mënyrë përkatëse të gjitha format e korrupsionit me Kodin Penal;
- ✎ Të anketuarit konsiderojnë se në veprat ekzistuese penale duhet të shtohen elementet e zhatjes seksuale, duke i potencuar veprat: detyrim, akte seksuale me keqpërdorim të pozitës dhe përdhunim;
- ✎ Është propozuar përkufizimi i zhatjes seksuale edhe me Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave.

Përgjigja institucionale

- ✎ Në raportet që i parashtron Republika e Maqedonisë së Veriut në GREKO nuk është bërë ndonjë lidhje ndërmjet korrupsionit dhe perspektivës gjinore;



Konkluzionet e përgjithshme



Njohja e zhvatjes seksuale si formë e korrupsionit dhe dhunës me bazë gjinore është karakteristike për ekspertët juridikë, akademikët, deputetet dhe përfaqësuesit e sektorit civil. Përfaqësuesit e vetëqeverisjes lokale e shohin zhvatjen seksuale si fenomen shoqëror që e njohin dhe e potencojnë me shembuj të jetës së përditshme, por nuk e perceptojnë si formë të korrupsionit. Të gjithë të anketuarit konsiderojnë se zhvatja seksuale është më së shumti e përfaqësuar në administratën shtetërore, arsimin e lartë dhe sektorin e biznesit dhe e se e njëjta më së shpeshti shfrytëzohet për punësim dhe avancim në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Sipas mendimeve të të anketuarve **viktimat e zhvatjes seksuale janë më së shpeshti gratë e reja**, ndërsa sanksioni duhet të orientohet ndaj atij që është në pozitë të fuqisë, respektivisht i cili e kryen zhvatjen. Megjithëse të gjithë të anketuarit konsiderojnë se zhvatja seksuale është shumë prezente në shoqërinë tonë, thonë se nuk denoncohet mjaftueshëm para se gjithash për shkak të turpfit, frikës dhe dënimit dhe humbjes së vendit të punës.

Pjesa më e madhe e të anketuarve konsiderojnë se Kodi Penal nuk e rregullon mjaftueshëm dhe/ose në mënyrë adekuate zhvatjen seksuale dhe pajtohen se zhvatja seksuale duhet të inkriminohet si një veprë e posaçme penale në Kodin Penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Gjithashtu të intervistuarit konsiderojnë se zhvatja seksuale duhet të përkufizohet edhe në Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave dhe Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen e grave nga dhuna dhe dhuna në familje. Si problem i madh u theksua edhe zbatimi joadekuat i ligjeve ekzistuese dhe mospasja e një përgjigjeje sistematike, si dhe nevoja për trajnime përkatëse për ta njohur zhvatjen seksuale për faktorët relevantë.

Kultura dhe vetëdija

Për të pasur mbrojtje efektive nga zhvatja seksuale si vepër e korrupsionit nevojitet që të ndërtojmë kulturë të njohjes së veprës, promovimit të ngushëllimit të viktimës së zhvatjes seksuale dhe dënimit të përgjithshëm të keqpërdorimit të funksionit publik ose autorizimit për marrje të shërbimit seksual. Ndërtimi i kulturës dhe vetëdijes së tillë mund të bëhet vetëm nëse kemi të dhëna për atë se sa është e përhapur kjo vepër e korrupsionit.

„Ndodh që nëse një grua shkon të kërkojë ndihmë sepse është ballafaquar me zhvatje seksuale fillimisht i drejtohet policisë për ta zgjidhur problemin, por atje do të qeshen me të. Ne ende nuk kemi kulturë lidhur me atë se dikush vërtet ka problem të cilin policia duhet ta zgjidhë, të veprojë për të, e jo të qeshen se na kanë zhvatur sepse paskemi qenë gra të bukura.“ – Marta Gusar, avokate (Intervista 25.08.2021)

Me qëllim për t'i analizuar më hollësisht gjendjet me format gjinore të korrupsionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në qershor 2021 Agjencia Instituti TIM realizoi sondazh të mendimit publik. Sondazhi ka përfshirë 1013 gra nga të cilat 55,8% me arsim të mesëm, 24% me arsim të lartë dhe 20,2% me arsim fillor dhe 58,8% jetojnë në vendbanime urbane, e 41,2% në vendbanime rurale. Me sondazhin është mbajtur llogari për përfaqësimin e komuniteteve etnike, dhe 24,6% të të anketuarve janë shqiptare, 68,4% maqedonase dhe 7% u përkasin komuniteteve tjera më të vogla etnike.

Në fokus të sondazhit ishte zhvatja e shërbimeve seksuale nga të punësuarit në sektorin publik në këmbim për të ofruar ndonjë shërbim publik, si formë specifike gjinore e korrupsionit. Si formë e korrupsionit zhvatjen e shërbimeve seksuale nga të punësuarit në sektorin publik në këmbim për të ofruar ndonjë shërbim publik **e njohin 78% e të anketuarve**. Mbi gjysma e të anketuarve kanë theksuar se **bartësit e funksioneve dhe autorizimeve publike që nuk kanë pozitë të fuqisë ndodh që të kërkojnë shërbime seksuale në vend të parave/mitës në këmbim për të ofruar shërbim publik për të cilën janë kompetentë**, ndërsa 21,5% e tyre kanë theksuar se kjo ndodh shumë shpesh.

Dy e treta e të anketuarve konsiderojnë se zhvatja e shërbimeve seksuale në këmbim për të marrë ndonjë shërbim publik ndodh **edhe në sektorin publik dhe privat**. Institucioni në të cilin të anketuarit konsiderojnë se më shpesh ndodh zhvatja seksuale si formë e korrupsionit, **është administrata shtetërore (në nivel qendror dhe lokal)**. Institucionet tjera ku më shumë se gjysma e të anketuarve theksojnë mendim për prezencë të zhvatjes seksuale si formë e korrupsionit janë **arsimi dhe shëndetësia**. Situatat më të shpeshta në të cilat personat që janë në pozitë të fuqisë kërkojnë shërbime seksuale në këmbim për të ofruar shërbim publik për të cilin janë kompetentë **janë punësimi dhe avancimi**.



Mbi 63% e të anketuarve kanë theksuar se **nuk denoncojnë as përvojë personale as të huaj** lidhur me këtë formë të korrupsionit, por gjithsesi duhet të merret parasysh se denoncimi i zhatjes së shërbimeve seksuale lë hapësirë për etiketim shoqëror dhe shqetësim që pasqyrohet në jetën e mëtejme të gruas. Një e katërta e të anketuarve kanë theksuar se nuk kanë pasur përvojë personale, por njohin dikë që ka kaluar përmes kësaj forme të korrupsionit dhe **5,4% e të anketuarve të cilat kanë përjetuar personalisht dhe janë përbullur me pasojat e zhatjes së shërbimeve seksuale**. Nga këto 54 të anketuar (5,4%), vetëm **20 kanë shprehur gatishmëri për ta denoncuar këtë presion** dhe të ballafaqohen me sfidën për zbardhje të përvojës (37%).

Nga gjithsej 142 e të anketuarve, 40% ose 57 prej tyre theksojnë mosbesim në sistemin me përgjigjen se denoncimi nuk do të ketë kurrfarë efekti. **Te 36% ose 51 të anketuar, do të dominojë frika dhe gjykimi nga rrethina si rezultat i të cilave nuk do të denoncojë**, ndërsa te 20% ose 28 të anketuar nuk do të denoncojnë nga frika se do të gjykohej se janë vetë fajtorë ose vetë e kanë shkaktuar zhatjen e shërbimeve seksuale. Pjesa më e madhe e të anketuarve (afro 70%) **konsiderojnë se zhatja e shërbimeve seksuale si formë specifike e korrupsionit nuk është mjaft e njohur në publik** – në diskutimet, në politikat dhe rregullat ligjore në vendin tonë.

Analiza komparative tregoi se kultura e njohjes së kësaj veprë të korrupsionit ndërtohet përmes trajnimeve, fushatave publike dhe futjes së kodeve të sjelljes me të cilat disiplinohen tentimet, përkatësisht ndalohen veprimet e keqpërdorimit të funksionit ose autorizimit publik në këmbim me marrëdhënie seksuale. Kodet e tilla mund që në afat të shkurtër të ndihmojnë dhe t'i tejkalojnë mangësitë e kornizës juridike maqedonase e cila momentalisht nuk e rregullon në mënyrë specifike veprën e zhatjes seksuale si vepër e korrupsionit. Për shembull Kodi i sjelljes dhe etikës i Komisionit për Shërbime Publike të Ugandës ndalon që “nëpunësit të detyrojnë dikë në sjellje të natyrës seksuale e cila mund të ketë ndikim në dinjitetin e tij, e cila nuk është e mirëseardhur, nuk është racionale dhe paraqet njëfarë forme të sulmit ndaj personit”⁶⁷. Ky Kod parasheh edhe sanksione si për shembull suspendim të shërbimit dhe kompensim të viktimës si dhe largim nga shërbimi. Megjithatë përveç procedurave disiplinore dhe humbjes së vendit të punës, kodet nuk mund të rregullojnë dënime tjera gjë që e kufizon deri diku efektivitetin e tyre.

Nuk duhet vetëm të shkruhet, por edhe të jemi të trajnuar për ta aplikuar⁶⁸. Realizim të programeve për trajnim të cilat do të mundësojnë që të gjithë pjesëmarrësit në procedurën veçanërisht prokurorët, gjykatësit, avokatët, policia, por edhe personat e emëruar si persona kontakti për antikorrupsion të njoftohen për veprën, esencën e saj, që të mund ta njohin dhe dallojnë nga veprat tjera të korrupsionit dhe veprat tjera të dhunës me bazë gjinore, si dhe procedurën gjatë veprimit dhe mbrojtjes së viktimës gjatë veprave të tilla. Momentalisht kemi disa vende të cilat e rregullojnë veprën, por ekzistojnë shumë raste të veprimit për këtë vepër, përfshirë edhe për shkak të nivelit

⁶⁷ Cituar në IAWJ, Marval O'Farrell Mairal, Thomson Reuters Foundation, 2018:8

⁶⁸ Marta Gusar, avokate (Intervistë 25.08.2021)

të ulët të vetëdijes, njohurisë dhe kulturës së aktorëve kryesorë që janë përfshirë në procedurën. Kjo, organizimin e trajnimeve dhe aktiviteteve specialiste për ngritjen e vetëdijes të përfaqësuesit e drejtësisë e bën prioritet për rregullimin efektiv dhe mbrojtje nga zhatja seksuale si vepër e korrupsionit.

Përfundimisht nevojiten fushata për rritje të vetëdijes së gjithë popullatës për të hequr stereotipat me të cilat është normalizuar praktika e zhatjes seksuale dhe është bërë e pranueshme bile edhe me vlerën më të vogël të mitës. Rritja e vetëdijes dhe vepra ekziston, se bëhet fjalë për vepër të korrupsionit dhe se është përhapur në vend, e rregulluar dhe e ndëshkueshme sipas ligjit duhet të realizohet pas miratimit të ndryshimeve të kornizës ligjore dhe rregullimit specifik të veprës. Gjithashtu duhet t'u kushtohet vëmendje e veçantë mediave të cilat duhet në mënyrë specifike të targetohen me trajnime për atë si të njoftojnë në raste të zhatjes seksuale që të mos bëjnë vepër të ligë dhe ta vënë viktimën në gjendje ende më të cenueshme.



Rekomandime

Rekomandime për rregullim juridik të zhatjes seksuale si formë e korrupsionit

- Definimi adekuat, inkriminimi dhe sanksionim i zhatjes seksuale me Kodin Penal të Republikë së Maqedonisë së Veriut;
- Definimi i zhatjes psikike, përkatësisht presionit psikik në Kodin Penal;
- Definimi i zhatjes seksuale në Ligjin për mbrojtje dhe parandalim të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje dhe vendosja e masave urgjente për parandalim dhe mbrojtje;
- Definimi i zhatjes seksuale si veprim korruptiv në Ligjin për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave;
- Harmonizimi i Ligjit për marrëdhënie pune dhe Ligjit për mbrojtje nga shqetësimi në vendin e punës me Konventën 190 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës;
- Definimi i zhatjes seksuale në Ligjin për arsimin e lartë;
- Definimi i zhatjes seksuale në Ligjin për arsimin e lartë;
- Përfshirja me ligje e të gjitha formave të zhatjes seksuale si dhe të gjithë kryerësve potencialë;
- Ndjekja dhe vlerësimi i implementimit të ligjeve në çdo dy vite.

Rekomandime për përgjigje institucionale efikase ndaj rasteve të zhatjes seksuale

- Përfshirja e perspektivës gjinore në Planin vjetor për parandalimin e korrupsionit të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale;
- Përfshirja e perspektivës gjinore në punën e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit;

- ✎ Futja e rregulloreve dhe protokolleve të brendshme për parandalimin e korrupsionit përfshirë edhe format gjinore të korrupsionit në institucionet publike dhe private;
- ✎ Vendosja e sistemit funksional të denoncimit të zhatjes seksuale;
- ✎ Rritja e vetëdijes te popullata për ekzistimin e problemit dhe nxitjes së denoncimit
- ✎ Rritja e numrit të grave në pozita udhëheqëse si në sektorin publik, ashtu edhe në sektorin privat;
- ✎ Rritja e numrit të grave në politikë, veçanërisht në nivel lokal;
- ✎ Ulja e shkallës së papunësisë;
- ✎ Kufizimi i numrit të mandateve në pozita udhëheqëse në sektorin publik;
- ✎ Ndërgjegjësimi gjinor dhe edukimi gjinor i nëpunësve policorë.

Rekomandimi legjislativ për rregullimin e zhatjes seksuale në Kodin Penal

Rregullativa ligjore momentale:

Marrëdhënie seksuale duke keqpërdorur pozitën

Neni 189

(1) Ai cili duke keqpërdorur pozitën do të detyrojë në marrëdhënie seksuale ose akt tjetër seksual person i cili ndaj tij gjendet në pozitë vartëse ose varësie ose me qëllim të njëjtë e maltreton, frikëson ose ndaj tij vepron në mënyrë me të cilën poshtërohet dinjiteti i njeriut dhe personaliteti i njeriut, do të dënohet me burgim së paku pesë vite.

(2) Nëse veprën nga paragrafi (1) i këtij neni e kryen personi në gjini në vijë të drejtë ose vëllai, përkatësisht motra, mësimdhënësi, edukatori, birësuesi, kujdestari, njerka, mjeku ose personi tjetër duke keqpërdorur pozitën ose gjatë kryerjes së dhunës në familje do të kryejë marrëdhënie seksuale ose akt tjetër seksual me fëmijë i cili ka mbushur 14 vjet që i është besuar për mësim, edukim, ruajtje ose kujdes, do të dënohet me burgim së paku dhjetë vite.



(3) Kryerësit të veprës nga paragrafi (2) gjykata do t'i shqiptojë ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës nën kushte nga neni 38-b të këtij kodi.

Për shkak të mospërdorimit të nocionit “seksual/e” në Kodin Penal, e në vend të tij të përdoret nocioni “gjinor/e” propozohet ndryshimi në vijim:

Propozimi 1

Ndryshimi i emërtimit të veprës nga “abuzim seksual” në “marrëdhënie seksuale duke keqpërdorur pozitën“

Opsioni 1

Plotësimi i paragrafit 1

Ai i cili duke keqpërdorur pozitën do të detyrojë në marrëdhënie seksuale ose akt tjetër seksual person i cili ndaj tij gjendet në pozitë vartëse ose varësie “duke shfrytëzuar pozitën, nevojën oselidhjen e varësisë të bazuar në punësim, pozitë vartëse” ose lidhje tjetër varësie kur kryerësi e përdor dukshëm këtë varësi” ose me qëllimin e njëjtë e maltreton, e frikëson ose e trajton në mënyrë që e poshtëron dinjitetin njerëzor dhe personalitetin njerëzor, do të dënohet me burgim së paku pesë vjet.

Opsioni 2

Ndryshimi i nenit ekzistues me paragrafin (3) si vijon:

(3) Nëse vepra nga paragrafi (1) i këtij neni kryhet duke shfrytëzuar pozitën, nevojën ose lidhjen e varësisë të bazuar në punësim, pozitë vartëse ose lidhje tjetër varësie kur kryerësi e shfrytëzon dukshëm këtë varësi, do të dënohet me burgim së paku pesë vite.

Paragrafi ekzistues 3 do të bëhet 4 si vijon:

(3) Kryerësit të veprës nga paragrafi (2) dhe paragrafi (3) gjykata do t'i shqiptojë ndalim për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës në kushte nga neni 38-b të këtij kodi.

Propozim 2

Propozohet futje të nenit të ri dhe vepër penale si vijon:

Neni 189a

„Marrëdhënie seksuale duke keqpërdorur pozitën “

(1) „Çdo person që do të përdorë kërcënime, forcë ose presion psikologjik për të nxitur një person tjetër, i cili, për shkak të pozitës pronësore, familjare, shoqërore, shëndetësore ose pozitë tjetër ose gjendjes së vështirë në raport me të është në pozitë të varur, që të kryejë ose të detyrohet në marrëdhënie seksuale ose akt tjetër seksual duke shfrytëzuar pozitën, nevojën ose lidhjen e varësisë në bazë të punësimit, pozitës vartëse ose lidhjes tjetër të varësisë kur kryerësi e përdor këtë varësi, do të dënohet me burgim së paku pesë vite.”

(2) Kryerësit të veprës nga paragrafi (2) gjykata do t'i shqiptojë ndalim të kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës në kushte nga neni 38-b të këtij kodi.

Krahas inkriminimit të veprës zhvatje seksuale propozojmë edhe definimin dhe rregullimin e saj në ligjet civile në vijim:

Draft-dispozitat për rregullimin e zhvatjes seksuale në Ligj për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave

Propozohet në pjesën “Domethënia e shprehjeve të përdorura në këtë ligj” përkatësisht në nenin 8 të plotësohet paragrafi 5 si vijon:

(5) Me nocionin “dobi” nënkuptohet realizimi i secilit lloj të shërbimit, përfitimit, volitshmërisë ose përparësisë materiale, jomateriale ose sociale, shërbimit seksual ose përparësisë për vete ose për tjetër.

Në nenin e njëjtë 8 propozohet futja e paragrafit 12 si vijon:

(12) Me nocionin “forma gjinore e korrupsionit” nënkuptohet keqpërdorimi i pozitës shkaktim të dëmit material ose jomaterial ndaj grave dhe/ose i godasin në mënyrë disproporcionale gratë. Format gjinore të korrupsionit ndaj grave i përfshijnë shkaqet dhe rezultatit nga raporti i pabarabartë i fuqisë ndërmjet grave dhe burrave si rezultat i problemit shoqëror e jo individual.



Draft-dispozita për rregullimin e zhatjes seksuale në Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen e grave nga dhuna dhe dhuna në familje

Në Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen e grave nga dhuna dhe dhuna në familje propozohet plotësim i Listës së nocioneve përkatësisht nenit 3 me paragrafin 26 si vijon:

(26) Zhatja seksuale paraqet detyrim të marrëdhënies seksuale ose aktivitet tjetër seksual duke shfrytëzuar ose keqpërdorur pozitën, nevojën ose lidhjen e varësisë të bazuar në punësim, pozitë vartësie ose lidhje tjetër varësie në këmbim me shërbim, të mirë, qasje në resurs me të cilin menaxhon personi në pozitë, për të cilin vendos ose me të cilin udhëheq.

Aneksi I

Lista e faktorëve të intervistuar relevantë:

- Biljana Ivanovska - Kryetare e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit
- Vladimir Georgiev - Anëtar i Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit
- Gabriela Gajdova - Gjykatëse në Gjykatën Themelore Veles
- Lidija Raiçeviq – Prokurore Publike në Prokurorinë Themelore Publike – Shkup
- Aleksandar Markoski - Prokuror publik në Prokurorinë Themelore Publike Shkup
- Marta Gusar - Avokate në Zyrën e Avokatisë Marta Gusar
- Natasha Gaber Damjanovska - Drejtoreshë e Akademisë së Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë
- Aneta Arnaudovska - Eksperte rajonale në fushën e korrupsionit
- Nikolina Kenig - Profesoreshë e rregullt në Universitetin “Shën Cirili dhe Metodi”, Fakulteti Filozofik.
- Ljupço Nikollovski - Zëvendëskryeministër për luftë kundër korrupsionit dhe krimit, zhvillim të qëndrueshëm dhe burime njerëzore
- Elena Grozdanovska - Këshilltare Shtetërore për Barazi Gjinore dhe Mosdiskriminim, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
- Svetlana Cvetkovska, udhëheqëse e sektorit për mundësi të barabarta, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
- Elena Dimovska, këshilltare për monitorimin e kornizës ligjore kundër korrupsionit, Ministria e Drejtësisë
- Gordana Siljanovska - Kryetare e Komisionit për Mundësi të Barabarta në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut
- Zhaklina Peshevska - deputete dhe kryetare e Unionit të Grave të VMRO-DPMNE-së
- Snezhana Kaleska Vançeva - deputete dhe koordinatore e Forumit të Gruas LSDM



Lista e përfaqësuesve të njësive të vetëqeverisjes lokale me të cilat janë mbajtur grupe të fokusit:

- Suzana Petrovska – Koordinatorë për Mundësi të Barabarta – Komuna e Dellçevës
- Emilija Gjurçinovska Matevska - Koordinatorë për Mundësi të Barabarta - Komuna e Gazi Babës
- Kire Gjorgievski - Udhëheqës i Seksionit për Menaxhim me Resurse Njerëzore/Person përgjegjës për raportim të brendshëm të korrupsionit - Komuna e Manastirit
- Ubavka Stojanova - Zëvendëskoordinatorë për Mundësi të Barabarta në Komunën e Qendrës
- Marija Goceva - Person përgjegjëse për raportimin e brendshëm të korrupsionit në komunën e Qendrës
- Sllavica Dimova - Koordinatorë për mundësi të barabarta në komunën e Sveti Nikollës
- Azra Sadiku - Koordinatorë për mundësi të barabarta në komunën e Gostivarit

Lista e përfaqësuesve të sektorit civil me të cilat janë mbajtur grupe të fokusit:

- Mishaa Popovi - Instituti i Demokracisë “Societas Civilis” -IDSCS
- Maja Atanasova - Shoqata e Juristëve të Rinj
- Marija Todorovska-Porta e Hapur-La Strada
- Ana Avramoska - Rrjeti Kombëtar kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
- Natasha Boshkova- Koalicioni margjinat
- Lila Miliq-Star Star-Kolektivi i Parë i Punëtorëve seksualë në Ballkan
- Ina Xhungumanova - Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut.

